

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5651
E mërkurë, 12 dhjetor 2018
çmimi 0.40 €

Kërkohet përkrahje ndërkombëtare për personat e zhdukur

FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

**BE-JA DUHET TA
HEQË LOGJIKËN
E DYFISHTË DHE
MATJEN ME
DY KUTE!** F. 11



Bilall SHERIFI

**EDHE LUSHTAKU E MEHMETI
FTOHEN PËR INTERVISTIM
NGA SPECIALJA** F. 5

**GJERMANIA I BËN THIRRJE
KOSOVËS TA HEQË TAKSËN
NDAJ MALLRAVE SERBE** F. 3

EKONOMI


RRITEN ÇMIMET E KONSUMIT F. 9

**NDALOHET SHITJA E
MJETEVE PIROTEKNIKE PËR
TË MITURIT** F. 8



KULTURË

**LAHUTA, EPOSI I
KRESHNIKËVE
DHE UNESCO
SOT** F. 13



Zymer U. NEZIRI

SPORT

**ELIMINIMI NGA KUPA UA
'MBYLL' GOJËN
FUTBOLLISTËVE TË GJILANIT** F. 18

FLET PËR "EPOKËN E RE", TAHIR RRECAJ | FAQE 4-5



Gatishmëria për t'iu përgjigjur Speciales tregon për pafajësinë e komandantëve

Avokati Tahir Rrecaj beson në pafajësinë e ish-komandantëve të UÇK-së dhe në drejtësinë e Gjykatës Speciale. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se gatishmëria e ish-komandantëve të UÇK-së për t'iu

përgjigjur pozitivisht kërkesës për intervistim të Prokurorit të Specializuar tregon për pafajësinë e tyre. Rrecaj është shprehur i bindur se nëpërmjet këtij procesi do të vërtetohet edhe një herë pastërtia e luftës çlirimtare të

Kosovës sikurse është vërtetuar nga gjykata e UNMIK-ut, e EULEX-it dhe nga Gjykata Ndërkombëtare e Hagës. Avokati Rrecaj ka treguar se ende nuk dihet se në çfarë cilësie është thirrur për intervistim klienti i tij, Nazif Mehmeti

Haradinaj: Mogherini e ka 'mbytur' dialogun Kosovë - Serbi

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se përfaqësuesja e lartë e Bashkimit Evropian, Federica Mogherini, e ka 'mbytur' dhe ka çrregulluar dialogun Kosovë - Serbi. Ai ka thënë se Mogherini e ka kthyer dialogun për normalizim të marrëdhënieve në mes të dy vendeve në dialog për territore dhe kufij. Haradinaj ka vlerësuar se debati për kufij në Ballkanin Perëndimor nënkupton destabilizim | FAQE 3



**PSD-ja kërkon
nga deputetët
ta përkrahin
projektrezolutën
për dialogun me
Serbinë** | FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, Vasa, p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Veseli merr përkrahjen për ushtrinë nga senatori amerikan

PRISHTINË, 11 DHJETOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, gjatë qëndrimit të tij në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, është takuar edhe me senatorin Gary Peters. Sipas Veselit, senatori Peters është anëtar i Komitetit të Senatit të Forcave të Armatosura dhe i njëjti ka shprehur mbështetje

për transformimin e FSK-së në ushtri. "Në takim me senatorin, Gary Peters, një mik i madh i Kosovës. E falënderova për mbështetjen që i ka dhënë dhe po i jep Kosovës. Si anëtar i Komitetit të Senatit për Forca të Armatosura, me senatorin Peters diskutuam për transformimin e FSK-së në Ushtri të

Kosovës. Ai shprehi përkrahjen e plotë si dhe patëm një diskutim shumë përmbytësor për misionin dhe ngritjen e kapaciteteve të ushtrisë sonë pas transformimit. Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të jenë gjithmonë përkrah Kosovës", ka shkruar kryeparlamentari Veseli në Facebook.



Përfundon ultimatumit, studentët bllokojnë Tiranën

Pas mbarimit të afatit, studentët deklaruan se protesta duhet të zhvendoset drejt Kryeministrit. Pas shumë varianteve që u hodhën për diskutim, studentët vendosën ta bllokojnë fillimisht rrugën te "Zogu i Zi". Po ashtu, vala e protestave ka ngritur të gjithë Shqipërinë "në këmbë", pasi nga që jugu në veri është protestuar pasditën e së martës



TIRANË, 11 DHJETOR - Të martën, në orën 16:00, përfundoi ultimatumit i studentëve ndaj kryeministrit Edi Rama. Shumica e studentëve, pas mbarimit të afatit, deklaruan se protesta duhet të zhvendoset drejt Kryeministrit. Pas shumë varianteve që u hodhën për diskutim, studentët vendosën ta bllokojnë fillimisht rrugën te "Zogu i Zi". Në protestë nuk munguan thirrjet për të qëndruar ende në Ministrinë e Arsimit. Shumica e studentëve deklaruan se nuk kanë se çfarë të bëjnë më të Ministria e Arsimit. Deri në orët e vona të së martës ende nuk ka një vendim të qartë se cila do të jetë rrjedha e protestës. Ajo që kuptohet është se studentët, për shkak se nuk kanë një organ drejtues, ndikohen nga vendime të çastit dhe nuk kanë vendim të unifikuar. Ideja e vazhdimit të protestës të Ministria e Arsimit nuk ka më sens, megjithatë një pjesë e studentëve që nuk dihet se çfarë duan realisht kur thonë se do të qëndrojnë aty. Fakti është se grupimi që kërkoi të qëndronin te Ministria e Arsimit është Organizata Politike e drejtuar nga pedagogu Arlind Qorri, të cilët nuk dihet se çfarë presin të marrin më nga Ministria e Arsimit.

Pas vendimit të studentëve, ka

reaguar sërish kryeministri Edi Rama lidhur me protestën e studentëve, këtë herë në "Instagram". "Gjithçka na duhet është të flasim. Parulla e njëjës prej protestave më madhështore të vitit 2018 në Evropë", shkruan Rama në "Instagram". Turma më e madhe e studentëve ndodhej te "Zogu i Zi". Nuk dihet saktësisht se si do të vijojë kjo protestë, pasi tashmë studentët janë ndarë në dy pjesë. Në shesh nuk janë vetëm studentët që prej shtatë ditësh protestojnë kundër reformës në arsim. Vala e protestave ka ngritur të gjithë Shqipërinë "në këmbë", pasi nga jugu në veri është protestuar pasditën e së martës. Në Kurbin qytetarët kanë bllokuar të martën në shenjë proteste "Rrugën e Kombit" dhe kërkojnë ulje të taksave, ulje të çmimit të karburantit dhe të çmimit të energjisë elektrike. Me pankarta në duar ata lëshuan thirrje kundër qeverisë së Edi Ramës. Sipas njoftimeve, pjesa më e madhe e banorëve në protestë të cilët kanë veshur jelekët portokalli, janë familjarë dhe përfaqësues të bizneseve të vogla të zonës. Ata kanë shprehur shqetësimin se ndihen të rrezikuar për shkak të taksave të larta.

Ndërkohë protesta paralele po

zhvillohen në Shkodër, Korçë, Vlorë, Fier, Elbasan, Durrës dhe Dibër. Qytetarët kanë dalë në rrugë dhe kanë bllokuar akset kryesore të vendit, duke thirrur në kor: "Rama ik!" Aksi Korçë - Kapshticë është bllokuar dhe fer-

merët kanë hedhur në rrugë prodhimet e tyre, ndërsa edhe autostrada Tiranë - Durrës është bllokuar prej pasditen e së martës në të dy krahët. E njëjta situatë paraqitet edhe në autostradën Tiranë - Elbasan, ku

prej bllokimit nga protestuesit radha e automjeteve ka shkuar në 1.5 km. Edhe në Vlorë qytetarët kanë bllokuar hyrjen e autostradës Vlorë - Fier, ndërsa në Shkodër qindra qytetarë kanë djegur goma në rrugë.

Basha: Jemi me studentët, një ndryshim po lajmërohet

TIRANË, 11 DHJETOR - Në fjalën e tij gjatë ceremonisë që përkujtoi themelimin e Partisë Demokratike më 11 dhjetor 1990, lideri demokrat Lulzim Basha ka përsëritur protestën e studentëve dhe tha se në Shqipëri po lajmërohet një ndryshim këto ditë. "Një ndryshim po lajmërohet këto ditë në Shqipëri. Kjo lëvizje është shumë më shumë sesa tarifata universitare, është shumë më shumë

sesa kjo që shohin sot. Është armatosja me kurajë që të mos heshtim më kur qeveria i merr nëpër këmbë. Prej tetë ditësh shohim thirrjen e të rinjve. Lëvizja studentore është bekim për Shqipërinë", u shpreh Basha. Në vijim ai theksoi se popullit i ka vajtur thika në palcë, ndaj ka shpërthyer revolta në të gjitha qytetet. "Janë orë të revoltës popullore sepse studentët janë sakri-

ficë duke thirrur një dhjetor të dytë. Gjithë respekti është për ta, kjo është liria, kjo është demokracia. Ne jemi me ta, PD-ja është me ta, qytetarët janë me ta. E sotmja nuk është një ditë festimi, por një ditë nderimi. Ortakëria e babëzitur mes pushtetarëve dhe mes segmenteve të kapura ka dobësuar deri në koma mekanizmat e mbikëqyrjes së qeverisë", tha Basha.

Gruevski shëtit lirshëm nëpër rrugët e Hungarisë

Shkup, 11 dhjetor - Ish-kryeministri i Maqedonisë në arrati, Nikolla Gruevski, në një fotografi që po qarkullon nëpër rrjetin social "Facebook", mendohet të

jetë kapur duke shëtitur rrugëve të Hungarisë. Autenticiteti i fotografisë nuk është konfirmuar ende. Kujtojmë që ish-kryeministri raportohet të ketë kërkuar

ndihmë nga personalitete të fuqishme politike në Bashkimin Evropian për ta shmangur dënimin e tij me burgim, përmes një letre dërguar më 16 tetor, përpara

se të arratiset përmes Shqipërisë, Malit të Zi dhe Serbisë, për në Hungari, ku edhe ka aplikuar për azil politik dhe të cilin e ka fituar tashmë.



Qeveria e Republikës së Kosovës ka mbajtur mbledhjen e radhës

Haradinaj: Mogherini e ka 'mbytur' dialogun Kosovë - Serbi



Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se përfaqësuesja e lartë e Bashkimit Evropian, Federica Mogherini, e ka 'mbytur' dhe ka çrregulluar dialogun Kosovë - Serbi. Ai ka thënë se Mogherini e ka kthyer dialogun për normalizim të marrëdhënieve në mes të dy vendeve në dialog për territore dhe kufij. Haradinaj ka vlerësuar se debati për kufij në Ballkanin Perëndimor nënkupton destabilizim

zbatimin e marrëveshjeve. Debati për kufij ka shkaktuar dalje nga kontrolli. Është për keqardhje pas një investimi kaq të madh të BE-së të kemi një çrregullim të tillë", është shprehur Haradinaj, duke shtuar se Kosova mbetet e përkushtuar për t'i kryer detyrat e saj dhe për t'u bërë pjesë e familjes evropiane. Në këtë kontekst, ai ka theksuar se raportet ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian nuk varen prej një komisionare apo një kryeministri.

"Marrëdhëniet e Kosovës me Evropën nuk janë të lidhura me një komisionar apo me një kryeministër apo dikë tjetër, sepse unë nuk e kam personale me askënd. Kushdo që i lejon vetes të flasë për opsionet e kufijve, e di që është kundër Ballkanit, e di që është kundër paqes dhe kundër normalizimit. Ato pikërisht na kanë sjell pikërisht ku jemi sot, këto çrregullime të dialogut", ka thënë Haradinaj. Shefi i Qeverisë ka folur edhe për

masën prej 100 përqindësh ndaj produkteve të importuara me origjinë nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina, për të cilën ka thënë se është vendosur ndaj shtetit të Serbisë dhe në asnjë mënyrë ndaj qytetarëve serbë. Haradinaj ka ritheksuar se kjo masë nuk do të hiqet deri në njohjen e Republikës së Kosovës nga Serbia. Ndërsa sa i përket dorëheqjes së katër kryetarëve të komunave veriore, ai ka thënë se një vendim i tillë është antikushitetues.

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 11 DHJETOR - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, të martën u është kundërpërgjigjur deklaratave të përfaqësueses së lartë të Bashkimit Evropian, Federica Mogherini, e cila nuk e ka përjashtuar idenë për korrigjim të kufijve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ai ka thënë se Mogherini e ka 'mbytur' dialogun, nga një dialog për normalizim, e ka kthyer në një dialog për kufij. "Mendoj se zonja Mogherini e ka mbytur dhe çrregulluar dialogun. Nga një dialog për normalizim, e ka kthyer në një dialog për kufij e shkëmbime që në Ballkanin Perëndimor nënkupton destabilizim. Ajo e ka dëmtuar rajonin tonë duke lejuar

diskutimin për kufij dhe territore si dhe duke guxuar që në publik të deklarohet për këtë çështje. Qëndrimi i saj është i papranueshëm dhe kuptohet se nuk vlen mendimi i saj për ne, për mua të paktën", ka deklaruar Haradinaj të martën në një konferencë për medie pas mbledhjes së rregullt të Qeverisë së Kosovës. Ai ka thënë se debati për kufij ka ndikuar që procesi i dialogut të dalë nga kontrolli. Sipas Haradinajt, është për keqardhje që pas një investimi kaq të madh të BE-së të kemi një çrregullim të tillë. "Çrregullimet e dialogut na kanë sjellë këtu ku jemi sot. Sikur të kishim mbajtur dialogun në kornizë ashtu sikurse ka qenë vetëm për normalizim në mes të dy vendeve nuk do të kishim dalje nga kontrolli, pavarësisht prej vonesave që kanë ndodhur për

Qeveria ndan 66 mijë euro për shtesat e prokurorëve specialë

Kabineti qeveritar ka marrë vendim që të ndajë mjete në vlerë prej 66 800 eurosh për shtesat e pagave të prokurorëve të Prokurorisë Speciale. Shtesa për prokurorët ka vlerë 400 euro, ndërsaq për kryeprokurorin prej 500 eurove. Po ashtu, Qeveria ka marrë vendim për ndarjen e mjeteve financiare për aktivitetet e Qendrës për Studime Shqiptare në Londër në vlerë prej 21 379 eurosh. Kabineti qeveritar në mbledhjen e së martës i ka proceduar Kuvendit të Republikës së

Kosovës mendimin lidhur me Projektligjin për Pastërtinë e Figurës së Zyrtarëve të Lartë në Institucionet Publike dhe të të Zgjedhurve, i cili ka për qëllim ta kontrollojë pastërtinë e figurës të çdo zyrtari të lartë publik të zgjedhur apo të emëruar, lidhur me pjesëmarrjen e tij në strukturat politikëbërëse dhe zbatuese të sistemit komunist të ish-Jugosllavisë si dhe dhunës nga aparati shtetëror dhe strukturat e ish-shërbimeve sekrete për periudhën 1944 deri më 1999. Është aprovuar edhe rregullorja

për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive, me të cilën propozohet të ndryshohet emërtimi i tanishëm i Ministrisë së Infrastrukturës në Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit (MIT). Miratimin e Qeverisë e ka marrë edhe dokumenti i cili paraqet qëndrimin shtetëror të Republikës së Kosovës për Këshillin e Stabilizim Asociimit i cili do të mbahet më 17 dhjetor në Bruksel.

Gjermania i bën thirrje Kosovës ta heqë taksën ndaj mallrave serbe



PRISHTINË, 11 DHJETOR - Ministri i Jashtëm i Gjermanisë, Heiko Maas, i ka bërë thirrje të martën Kosovës për të anuluar apo të paktën për ta pezulluar zbatimin e taksës prej 100 përqindësh që Qeveria e Kosovës ka vënë për mallrat e Serbisë dhe të Bosnje Hercegovinës. "Duhet të parandalohet urgjentisht një përshkallëzim tjetër. Duhet të ruhet suksesi i dialogut për nor-

malizim", ka thënë Mass. Përveç të tjerash, Mass ka thënë se marrëdhëniet e përmirësuar në mes të të dyja vendeve do t'i shpejtojnë përpjekjet që Kosova dhe Serbia dhe shtetet e tjera të Ballkanit të jenë pjesë e Bashkimit Evropian. "Në vend se të mendojnë për ndryshim të kufijve, Beogradi dhe Prishtina duhet të fokusohen në një marrëveshje të zbatueshme që mbulon të gjitha

pyetjet e hapura dhe bën të mundur një normalizim gjithëpërfshirës", është shprehur ai. Qeveria e Kosovës ka marrë vendim javë më parë për vendosje të taksës 100 për qind në importet e Serbisë dhe Bosnje Hercegovinës. Kjo masë është kundërshtuar nga pala serbe dhe faktori ndërkombëtar, duke përfshirë Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimin Evropian.

Flet për "Epokën e re", Tahir Rrecaj

Gatishmëria për t'iu përgjigjur Speciales



Avokati Tahir Rrecaj beson në pafajësinë e ish-komandantëve të UÇK-së dhe në drejtësinë e Gjykatës Speciale. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se gatishmëria e ish-komandantëve të UÇK-së për t'iu përgjigjur pozitivisht kërkesës për intervistim të Prokurorit të Specializuar tregon për pafajësinë e tyre. Rrecaj është shprehur i bindur se nëpërmjet këtij procesi do të vërtetohet edhe një herë pastërtia e luftës çlirimtare të Kosovës sikurse është vërtetuar nga gjykata e UNMIK-ut, e EULEX-it dhe nga Gjykata Ndërkombëtare e Hagës. Avokati Rrecaj ka treguar se ende nuk dihet se në çfarë cilësie është thirrur për intervistim klienti i tij, Nazif Mehmeti

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 11 DHJETOR - Avokati Tahir Rrecaj ka bërë me dije se gatishmëria e ish-komandantëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) për t'u paraqitur në mënyrë vullnetare në Speciale tregon për pafajësinë e tyre. Ai është shprehur i bindur në pafajësinë e ish-komandantëve të UÇK-së të thirrur nga Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës për intervistim.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka vlerësuar se ky proces është edhe në interes të Kosovës dhe të atyre që pretendohet se do të jenë subjekt i gjyqimeve, duke shtuar se ata do të lirohen nga

një barrë e rëndë dhe e padrejtë. "Kjo do të thotë se këta individë janë plotësisht të pafajshëm dhe janë të gatshëm të ballafaqohen edhe me akuzat eventuale të prokurorisë, nëse do të ketë aktakuza. Kjo është vetëm një fazë e intervistimit dhe prej intervistimit të tyre mund të rrjedhë edhe vendimi i Prokurorit të Specializuar të Kosovës në Hagë, nëse do të ketë aktakuzë apo jo", ka thënë Rrecaj. Ai i ka ftuar të gjithë që t'i besojnë Gjykatës Speciale, duke shtuar se edhe një herë do të vërtetohet lufta e drejtë e UÇK-së. "Unë jam profesionist dhe i besoj një gjykate. Mendoj se të gjithë duhet t'i besojmë edhe në të ardhmen kësaj gjykate, sepse përmes këtij procesi do të

vërtetohet edhe një herë pastërtia e luftës çlirimtare të Kosovës sikurse është vërtetuar deri më tani nga gjykata e UNMIK-ut, e EULEX-it dhe nga Gjykata Ndërkombëtare e Hagës. Unë dua të besoj në pastërtinë e luftës çlirimtare", është shprehur ai.

Në këtë intervistë Rrecaj ka folur edhe për klientin e vet, Nazif Mehmetin, i njohur si komandant Dini, i cili është ftuar nga Specialja për intervistim në muajin janar. Ai ka treguar se Mehmeti ende nuk dihet se në çfarë cilësie është ftuar në Hagë. "Nuk i kanë treguar se në çfarë cilësie është i ftuar për intervistim. Pra, nuk dihet nëse është i ftuar si dëshmitar apo si i dyshuar. Unë do t'i dërgoj një kërkesë

tregon për pafajësinë e komandantëve

janar të vitit 2019.

"Epoka e re": Në çfarë cilësie është ftuar për intervistim?

Rrecaj: Nuk i kanë treguar se në çfarë cilësie është i ftuar për intervistim. Pra, nuk dihet nëse është i ftuar si dëshmitar apo si i dyshuar. Unë do t'i dërgoj një kërkesë Gjykatës Speciale, me të cilën do ta njoftoj se jam avokat i z. Mehmeti dhe do të kërkoj udhëzime të mëtutjeshme se si të veprohet me rastin.

"Epoka e re": Brenda çfarë kohe pritni të njoftoheni se në çfarë cilësie është i ftuar për intervistë klienti juaj?

Rrecaj: Unë do të kërkoj nga Dhomat e Specializuara se në çfarë cilësie është ftuar z. Mehmeti dhe për procedurat e mëtutjeshme. Besoj se nuk do të ketë vonesa dhe brenda një kohe të caktuar do të marrë përgjigje në kërkesën tonë.

"Epoka e re": Z. Mehmeti do të paraqitet vullnetarisht në Hagë?

Rrecaj: Patjetër. Mehmeti do të paraqitet vullnetarisht në Hagë në datat që është ftuar. Ai ka shprehur vullnetin të bashkëpunojë me këtë gjykatë kurdo që të ftohet.

"Epoka e re": Deri më tani kemi katër ish-komandantë të UÇK-së që janë ftuar për intervistim nga Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës në Hagë. Cili është vlerësimi juaj për fillimin e këtij procesi?

Rrecaj: Fillimi i këtij procesi ka qenë i pritshëm, meqenëse Kosova ligjet për këtë çështje i ka aprovuar para tre vjetëve dhe funksionalizimi i këtyre dhomave ka ndodhur në këtë vit. Ndoshta ky proces pak është vonuar. Mendoj se ky proces është edhe në interes të Kosovës dhe të gjithë atyre që pretendohet se do të jenë subjekt i gjyqimeve që të hiqet njëherë e përgjithmonë një barrë e cila po e mundon popullin, por edhe ata vetë si individë.

"Epoka e re": Meqenëse të gjithë të ftuarit të deritashëm për intervistim kanë shprehur gatishmërinë e tyre për të bashkëpunuar me këtë gjykatë, çfarë do të thotë kjo për Kosovën?

Rrecaj: Kjo do të thotë se këta individë janë plotësisht të pafajshëm dhe janë të gatshëm që të ballafaqohen edhe me akuzat eventuale të prokurorisë nëse do të ketë aktakuza. Kjo është vetëm një fazë e intervistimit dhe prej intervistimit të

tyre mund të rrjedhë edhe vendimi i Prokurorit të Specializuar të Kosovës në Hagë nëse do të ketë aktakuzë apo jo.

"Epoka e re": Keni ndonjë informacion nga kolegët tuaj avokatë se a është kontaktuar ndonjë person tjetër nga Specialja?

Rrecaj: Jo, deri më tani nuk kam asnjë informacion për dikë tjetër përpos këtyre që tashmë dihen. Në këtë fazë mund të ketë edhe të tjerë që mund të thirren për t'u intervistuar, por nuk mund të spekuloj.

"Epoka e re": Kjo gjykatë nga shumëkush është vlerësuar e padrejtë. Sa do të arrijë kjo të vendosë drejtësi?

Rrecaj: Unë jam profesionist dhe i besoj një gjykatë. Mendoj se të gjithë duhet t'i besojmë edhe në të ardhmen kësaj gjykatë. Përmes këtij procesi do të vërtetohet edhe një herë pastërtia e luftës çlirimtare të Kosovës, sikurse është vërtetuar deri më tani nga gjykatat e UNMIK-ut, të EULEX-it dhe Gjykata Ndërkombëtare e Hagës. Unë dua të besoj në pastërtinë e luftës çlirimtare.

"Epoka e re": Si mund t'i ndihmojë shteti i Kosovës personat që janë thirrur për intervistim nga kjo gjykatë?

Rrecaj: Shteti sigurisht se mund dhe duhet t'i ndihmojë këta persona në aspektin e mbështetjes financiare për mbulimin e shpenzimeve për të akuzuarit, edhe për familjarët e tyre gjatë vizitave në Hagë. Pra, shteti duhet t'i mbështesë ata për çdo gjë të nevojshme gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore.

Edhe Lushtaku dhe Mehmeti ftohen për intervistim nga Specialja

PRISHTINË, 11 DHJETOR (ER) - Prokuroria Speciale, me seli në Hagë, ka thirrur për intervistim Sami Lushtakun dhe Nazif Mehmetin. Arianit Koci, avokat i Lushtakut, nëpërmjet një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka njoftuar se më 14 janar të vitit të ardhshëm klienti i tij do të paraqitet pranë Zyrës së Prokurorit të Specializuar të Kosovës në Hagë. "Me autorizimin e klientit tim z. Sami Lushtaku, ju njoftoj se z. Lushtaku ka pranuar një ftesë që me datën 14 janar 2019 të paraqitet pranë Zyrës së Prokurorit të Specializuar të Kosovës (ZPS) në Hagë. Kjo është ftesë për intervistim. Z. Lushtaku do të paraqitet vullnetarisht dhe është i gatshëm të sqarojë çdo

rrethanë të cilën ZPS është duke e hetuar. Kjo është e gjitha për çfarë kemi njohuri tani për tani dhe me mirësjellje kërkoj nga gazetarët që të mos e kontaktojnë z. Lushtaku rreth kësaj çështjeje", ka thënë Koci. Ftesën që i është bërë Mehmetit, ish-komandant i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i njohur si "Dini", e ka konfirmuar avokati i tij, Tahir Rrecaj. "Ai do të intervistohet më 22, 23 dhe 24 janar, po ende nuk e di nëse intervistimi do të ndodhë në Kosovë apo në Hagë", ka thënë Rrecaj. Ftesa të njëjta para disa ditësh kanë marrë edhe Rrustem Mustafa dhe Sokol Dobruna. Dhomat e Specializuara të Kosovës janë funksionalizuar

plotësisht që nga 5 korriku i vitit 2017, kur ishte miratuar dokumenti për zhvillimin e procedurës penale, Rregullorja e Procedurave dhe Provave. Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar punojnë për hetimin e krimeve kundër njerëzimit, krimeve të luftës dhe veprave të tjera penale, në lidhje me akuzat nga Raporti i Këshillit të Evropës i vitit 2011. Në atë raport është thënë se gjoja krimet i kanë kryer pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës gjatë periudhës 1998 deri në vitin 2000. Në Dhomat e Specializuara dhe në Prokurori punojnë 150 persona me prejardhje nga e gjithë bota. Gjykatësit, të cilët janë 20, vijnë nga 14 vende.

Gjykatës Speciale, me të cilën do ta njoftoj se jam avokat i z. Mehmeti dhe do të kërkoj udhëzime të mëtutjeshme se si të veprohet me rastin", ka thënë Rrecaj.

"Epoka e re": Z. Rrecaj, ju jeni avokat i Nazif Mehmetit, i cili është i ftuar i radhës për t'u intervistuar pranë Zyrës së Prokurorit të Specializuar të Kosovës (ZPS) në Hagë. Kur është njoftuar klienti juaj?

Rrecaj: Këtë informatë e kam marrë të martën kur z. Mehmeti më ka angazhuar avokat mbrojtës të tij. Ai më ka treguar se të hënën në mbrëmje është kontaktuar nga një hetues i Gjykatës Speciale i cili e ka njoftuar se ai duhet të paraqitet në Hagë për të dhënë një intervistë më 22, 23 dhe 24



Kërkohet përkrahje ndërkombëtare për personat e zhdukur

GJENEVË, 11 DHJETOR (ER) - Me rastin e Ditës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, një delegacion i Republikës së Kosovës, i përbërë nga Jahja Lluka, këshilltar i kryeministrit, i emëruar Mbajtës i Dosjes për çështjen e personave të zhdukur, Ibrahim Makolli, kryetar i delegacionit për bisedime me Serbinë për çështjen e të zhdukurve, Arsim Gërxhaliu, drejtor i Institutit të Mjekësisë Ligjore, dhe Kushtrim Gara, udhëheqës i Njësisë së Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur, të shoqëruar nga Benjamin Nikoliqi, konsull në Konsullatën e Përgjithshme të Republikës së Kosovës në Gjenevë, kanë qëndruar në Gjenevë, ku kanë mbajtur konferencë për mediat zvicerane dhe ndërkombëtare për çështjen e personave të zhdukur. Me këtë rast u prezantua një përmbledhje për punën e realizuar në procesin e ndriçimit të fatit të personave të zhdukur gjatë luftës në Kosovë, respektimin e të drejtave të familjeve të personave të zhdukur, sfidat dhe punën në

vijim. Në këtë rast, ndër të tjera, u theksua se "që nga ditët e para të pasluftës e deri më sot tek institucionet ndërkombëtare dhe institucionet kompetente vendore (si në Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq dhe Komisionin Qeveritar për Persona të Zhdukur) janë evidentuar, sipas kërkesave të familjarëve, mbi 6 000 raste të personave të zhdukur, më saktësisht 6 057 persona të zhdukur si pasojë e luftës në Kosovë. Dhe, si rezultat i angazhimit të institucioneve kompetente dhe me përkrahjen e bashkësisë ndërkombëtare (para së gjithash Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe vendeve perëndimore të Bashkimit Evropian dhe Zvicrës), në përpjekje për ta respektuar të drejtën e familjarëve për të ditur për fatin dhe vendndodhjen e më të dashurve të tyre (e drejtë kjo e garantuar edhe me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës), nga 6 057 rastet e evidentuara të personave të zhdukur, aktualisht janë edhe 1 647 raste të hapura të personave të zhdukur".




Gjatë konferencës për media, në përgjigje edhe të pyetjeve të parashtruara, delegacioni potencoi "se, përkundër punës dhe rezultateve të arritura, jemi të vetëdijshëm që numri aktual i rasteve të hapura të personave të zhdukur, prej 1 647 personave janë rastet më të vështira për t'u ndriçuar. Republika e Kosovës, me përkrahjen e vazhdueshme të bashkësisë ndërkombëtare, vazhdon të jetë shembull në rajon dhe më gjerë në kuptimin e adresimit me prioritet të çështjes së personave të zhdukur dhe trajtimit të çdo informate që mund t'i kontribuojë zgjidhjes

së cilitdo rast të personave të zhdukur". Megjithatë, sipas delegacionit, adresa e zgjidhjes së kësaj problematike mbetet Beogradi zyrtar, pra institucionet e Serbisë. Andaj, kjo nënkupton edhe nevojën dhe domosdoshmërinë e përkrahjes së mëtutjeshme ndërkombëtare, në veçanti përmes ushtrimit të presionit ndaj autoriteteve serbe që të jenë më bashkëpunuese në këtë proces dhe përmes hapjes së arkivave të ushtrisë dhe policisë serbe, të ndihmojnë për zgjidhjen e të gjitha rasteve të personave të zhdukur.

Po gjatë qëndrimit në Gjenevë, delegacioni ka realizuar edhe një vizitë zyrtare në Zyrën Qendrore të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, ku është pritur nga drejtori i KNKK-së për Evropë dhe Azi Qendrore, Patrick Vial, dhe koordinatori i operacioneve për Evropë dhe Azi Qendrore, Nicolas Fleury. Gjatë takimit u diskutua për gjendjen aktuale të procesit të ndriçimit të fatit të personave të zhdukur si dhe për mundësitë e shtimit të bashkëpunimit mes institucioneve vendore dhe organizatave ndërkombëtare të angazhuara në këtë proces.

Ministri Ismaili: Në vetëm një bari për kancer shpëtuan 577 mijë euro



EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 11 DHJETOR - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka vazhduar publikimin e dëshmimeve rreth abuzimit të çmimeve me barna në kuadër të javës kundër korrupsionit. Të martën ministri Ismaili ka publikuar në llogarinë e vet në "Facebook" të dhënat e kontratave të "Imatinibit", barit që përdoret nga të sëmurët me kancer dhe leukemi. Sipas tij, ky bari më

herët ishte blerë për 32 euro një tabletë, me kontratë vjetore prej 652 mijë eurosh. Këtë vit i njëjti bari, e njëjta sasi, është blerë për 3.69 euro një tabletë, apo 75 mijë euro kontrata e përgjithshme njëvjeçare. "1 në 6 vdekje në botë ndodh prej sëmundjes së kancerit. Për shkak të korrupsionit barnat kundër kancerit te ne janë blerë shumëfish më shtrenjtë. 'Imatinibi' më herët është blerë për 652 mijë euro, ndërsa sasinë e njëjtë këtë vit e kemi blerë për 75 mijë euro. Në

vetëm një kontratë kemi shpëtuar 577 mijë euro. Në total, për barnat kundër kancerit ne kemi shpëtuar rreth një milion euro. Barna më shumë, çmime më të lira", ka shkruar ministri Ismaili. Ministri Ismaili një ditë më parë ka nisur publikimin e dëshmimeve për çmime abuzive për blerjen e barnave që kanë ndodhur në vitet e kaluara. Ai ka treguar se vetëm gjatë vitit 2018 janë blerë 6 milionë euro më lirë barna sesa në vitet paraprake për të njëjtat sasi.

Përkrahja e Çekisë, e rëndësishme për Kosovën

PRISHTINË, 11 DHJETOR (ER) - Ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka pritur të martën në takim, Pavel Bilek, i ngarkuar me punë në Ambasadën e Çekisë në Kosovë, me të cilin ka diskutuar për thellimin e bashkëpunimit dhe procesin integruar. Hoxha ka shtuar se Çekia ka qenë përkrahëse e vazhdueshme e shtetësisë së Kosovës. Ajo ka vlerësuar edhe përkrahjen e fundit në Parlamentin Evropian dhe Interpol me votën pro të këtij vendi mik. "Ne sot gjendemi

para një sfide të re, sfidës së liberalizimit. Pavarësisht prej realizimit të të gjitha kushteve për liberalizim, ne mbesim i vetmi vend i privuar nga e drejta themelore, lëvizja e lirë", ka thënë Hoxha, duke shtuar se ish-vendet me diktaturë komuniste e dinë më së miri ndjenjën e izolimit, kufizimit dhe procedurave të pakufishme për qytetarët për një vizë. I ngarkuari me punë i Ambasadës së Çekisë, Pavel Bilek, ka vlerësuar lart plotësimin e të gjitha kushteve për liberalizim dhe ka

rikonfirmuar përkrahjen e Çekisë në të gjitha proceset që po kalon Kosova, me theks të veçantë procesin integruar, reformat nga agjenda evropiane si dhe dialogun si një nga vlerat e Bashkimit Evropian. Ministrja Hoxha dhe Bilek u pajtuan që Kosova dhe Çekia kanë vullnet dhe gatishmëri ta thellojnë bashkëpunimin e ndërsjellë, duke marrë përvojat integruar, përkrahjen për Kosovën për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare, por edhe bashkëpunimin e gjithanshëm si dy vende mike.



PSD-ja kërkon nga deputetët ta përkrahin projektrezolutën për dialogun me Serbinë

EPOKA
ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 11 DHJETOR - Nënkretarët e Partisë Socialdemokrate (PSD), Visar Ymeri dhe Dukagjin Gorani, kanë ftuar të martën partitë politike, të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës, që ta përkrahin projektrezolutën dhe Projektligjin e PSD-Nisma-Alternativa për dialogun me Serbinë. Ymeri ka theksuar se procesi i tanishëm i dialogut është i pranueshëm vetëm nëse rezulton me njohjen e ndërsjellë të palëve të përfshira në këtë proces, me anëtarësimin e Republikës së Kosovës në OKB dhe me përshtetimin e proceseve integruese të shtetit tonë në NATO dhe BE.

Ai ka thënë se në këtë proces roli qendror i takon Kuvendit të Kosovës, i cili, sipas tij, duhet ta votojë delegacionin shtetëror. Në këtë kontekst, Ymeri ka thënë se detyrat, përgjegjësitë e kompetencat e këtij delegacioni duhet të definohen dhe saktësohen me Projektligjin e propozuar nga PSD-Nisma dhe Alternativa. "Delegacioni shtetëror ka të drejtën ekskluzive të komunikimit

dhe të interpretimit publik të procedimeve, përmbajtjes dhe arritjeve në procesin e dialogut. Vendimet brenda delegacionit do të jenë konsensuale, me pajtueshmërinë e të gjithë anëtarëve të tij. Delegacioni shtetëror do të raportojë në mënyrë të rregullt rreth ecurisë së procesit të dialogut para Komisionit për mbikëqyrjen e dialogut", ka thënë Ymeri.

Duke e shpjeguar ndërlidhjen në mes të projektrezolutës dhe Projektligjit, nënkryetari tjetër i PSD-së, Dukagjin Gorani, ka thënë se këto dokumente nuk kanë kuptim pa njëra-tjetrën. Ai ka thënë se rezoluta pa ligj nuk ka fuqi detyruese, kurse ligji pa rezolutë nuk ka as kontekst dhe as shpjegim politik. "Roli qendror i delegacionit shtetëror është i domosdoshëm për t'i evituar mospajtimet e mundshme politike dhe konfuzionin publik, që do të mund të shkaktohej nëse procesi negociator do të zhvillohej në instanca paralele", ka thënë Gorani, duke sqaruar se të dy dokumentet janë harmonizuar tashmë me AAK-në, Nismën, AKR-në dhe Alternativën. Gorani ka thënë se janë duke e pritur qëndrimin e PDK-së.



Ministri Bytyqi dhe shefja e BE-së biseduan me nxënës për dukurinë e korrupsionit

EPOKA
ERE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 11 DHJETOR - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi dhe shefja e Zyrës e BE-së në Kosovë, Nataliya Apostolova, kanë diskutuar të martën me nxënësit e shkollave të mesme për temën "Avokimi i ndryshimit kulturor: Roli i gjeneratave të reja për formësimin e vlerave të së nesërme", me theks dukurinë e korrupsionit si një e keqe që i kanoset të ardhmes së vendit. Në këtë diskutim kanë marrë pjesë edhe ambasadorja e



Holandës në Kosovë, Gerrie Willems, përfaqësuesi i Ambasadës Italiane në Kosovë, Matteo Corradini dhe drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit, Shaip Havolli, të cilët kanë theksuar rëndësinë e luftimit të korrupsionit.

Ministri Bytyqi me këtë rast ka theksuar se institucionet shtetërore, veçanërisht të rinjtë, luftimin e korrupsionit duhet ta

kenë përditshmëri, ndërsa tha se dihen dëmet që u shkakton kjo dukuri një vendi, të rinjve dhe qytetarëve në përgjithësi, sepse është pengesë serioze e zhvillimit.

Ministri ka thënë se fillimisht duhet ta pranojmë se kjo dukuri ekziston në vendin tonë, pastaj ta gjejmë mënyrën se si ta luftojmë. Megjithatë, ai ka shtuar se parandalimi i korrupsionit është shumë më i lehtë se luftimi i tij. "Të rinjtë duhet ta kuptojnë se është vlerë të jesh i ndershëm, është vlerë që çdo gjë që e bën ta fitosh me dije dhe djersë, e jo me forma të tjera korruptive", ka

deklaruar ministri Bytyqi. Ndërsa shefja e Zyrës e BE-së në Kosovë, Nataliya Apostolova, ka thënë se rinia e sotme është udhëheqësja e së nesërme. "Të gjithë ju mund të jeni forca kryesore që lufton korrupsionin, krimin e organizuar. Të gjitha këto të këqija ndikojnë negativisht në të ardhmen e Kosovës", është shprehur Apostolova.

Ky aktivitet u organizua në kuadër të "Javës kundër korrupsionit 2018" që po realizohet përmes "Projektit kundër krimit ekonomik" të Këshillit të Evropës.

Policia identifikon 29 fëmijë lëmshëkërkues në Kosovë

PRISHTINË, 11 DHJETOR (ER) - Policia e Kosovës ka zbatuar planin operativ 'Identifikimi i fëmijëve lëmshëkërkues si viktimë të mundshme të trafikimit', i cili është shtrirë në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, në periudhën kohore 3. 12. 2018 deri më 7. 12. 2018.

Në realizim të këtij plani, pos Njësisë të Drejtorisë për Hetimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore, kanë qenë të përfshirë edhe: prokuroritë e rajoneve përkatëse, qendrat për punë sociale, Drejtoria për Migrim dhe të Huaj e PK-së dhe njësitë policore nga

stacionet policore përkatëse. Gjatë zbatimit të këtij plani operativ janë hasur këto dukuri dhe kryer këto veprime: Janë identifikuar 29 fëmijë lëmshëkërkues (21 shtetas të Kosovës dhe 8 shtetas të Shqipërisë), janë identifikuar 13 persona të dyshuar, janë iniciuar 10 raste nga Neni 250 i Kodit Penal 'Keqtrajtimit apo braktisje e fëmijës', të gjithë fëmijët lëmshëkërkues kanë qenë të shoqëruar nga familjarët e tyre, gjatë marrjes në pyetje nuk është identifikuar asnjë viktime e trafikimit, shtetasit e huaj i janë dorëzuar Drejtorisë për Migrim

dhe të Huaj që t'i vazhdojnë veprimet bazuar në Ligjin për të Huaj, për shtetasit kosovarë, në konsultim me prokurorët përkatës, janë iniciuar dhjetë raste 'Keqtrajtimit apo braktisje e fëmijës'.

Policia e Kosovës ka bërë me dije se do të vazhdojë t'i realizojë detyrat kushtetuese dhe ligjore, t'i shtojë aktivitetet për luftimin e dukurive antiligjore, ta mbajë rendin dhe sigurinë publike, t'i parandalojë dhe t'i zbulojë veprat penale, përfshirë keqtrajtimitin e fëmijëve dhe trafikimin e njerëzve.



Ndalohet shitja e mjeteve piroteknike për të miturit

EPOKA E RE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 11 DHJETOR - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Endrit Shala, ka lëshuar një urdhëresë për trupat koordinuese për mbikëqyrjen e tregut që ndalon shitjen e mjeteve piroteknike për personat nën moshën 18 vjeç. Shala ka thënë se me këtë urdhëresë obligon inspektoratin e tregut t'i kontrollojnë operatorët ekonomikë, me këtë rast t'i verifikojnë nëse janë të licencuar dhe plotësojnë kriteret për tregti dhe furnizim me produkte piroteknike. "Sot kam urdhëruar trupën koordinuese për mbikëqyrjen e tregut që kryesohet nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, që t'i koordinojë aktivitetet me organet përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut për kontrollimin e operatorëve ekonomikë të cilët merren me tregtinë dhe shitjen

e mjeteve piroteknike. Me këtë urdhëresë kam obliguar Inspektoratin e Tregut dhe inspektorët kompetentë për siguri publike që t'i kontrollojnë operatorët ekonomikë, me këtë rast t'i verifikojnë nëse janë të licencuar dhe plotësojnë kriteret për tregti dhe furnizim me produkte piroteknike", ka thënë ministri Shala.

Shala ka theksuar se ka urdhëruar që të ndalohet shitja apo tregtimi i këtyre produkteve piroteknike për të gjithë personat jokompetentë dhe personat nën moshën 18-vjeçare. "Ne po punojmë çdo ditë që ta mbrojmë konsumatorin tonë, t'u rrimë afër dhe ta kontrollojmë cilësinë e produkteve në treg dhe tregun në përgjithësi, duke mos lejuar dhe parandaluar çdo lloj fatkeqësie që mund t'i ndodhë qytetarit tonë. Ne jemi në vëzhgim të tregut edhe kur vjen puna te produktet piroteknike që kanë shkaktuar



jo pak dëme nëpër vite. Andaj u bëj thirrje operatorëve ekonomikë ta respektojnë këtë

urdhëresë, përndryshe pasojnë gjokat. Ne nuk jemi të interesuar të gjobisim, por të

bashkëpunojmë për kontrollimin e tregut, sidomos të cilësisë", ka thënë ministri Shala.

Mundësi bashkëpunimi në mes të Kosovës dhe Sllovenisë në fushën digjitalizimit të administratës



PRISHTINË, 11 DHJETOR (ER) - Në kuadër të vizitës zyrtare dhe takimeve të shumta dhe të rëndësishme në Slloveni, ministri i Ministrisë së Inovacionit, Besim Beqaj, ka takuar të martën ministrin e Administratës Publike të Sllovenisë, Rudi Medved.

Tema kryesore të takimit ishin: mundësia e bashkëpunimit në

mes të Kosovës dhe Sllovenisë në fushën e digjitalizimit të administratës dhe ekonomisë dhe bashkëpunimi për ndërtimin e kapaciteteve të prodhuesve kosovarë për të qenë partnerë dhe konkurrues në tregjet ndërkombëtare përmes qasjes së përbashkët në hulumtim, ndërmarrësi inovative, ndërkombëtarizim të

ekonomisë. "Sllovenia është një nga shtetet lidere në Evropë për inovacion dhe digjitalizim, fakt ky shumë i rëndësishëm për të përfituar nga ekspertiza dhe përvojat më të mira sllovene", ka thënë me këtë rast ministri Beqaj. Ai ka thënë se marrëdhëniet e shkëlqyera ndërshtetërore do të forcohen me vazhdim të bashkëpunimit të

fuqishëm në fushën e digjitalizimit të administratës shtetërore dhe ekonomisë, për ngritjen e kapaciteteve njerëzore, qasjen e përbashkët në tregjet e treta dhe asistencë profesionale teknike për përfitimin nga programet e financimit të BE-së.

Gjatë qëndrimit në Slloveni ministri Besim Beqaj do të ketë takime edhe me udhëheqësit e

Tech Parkut të Lubjanës dhe me drejtuesit e Odës Ekonomike dhe të Industrisë së Sllovenisë, me qëllim të marrjes së ekspertizës sllovene për funksionimin e qendrave të inovacionit, si dhe bashkëpunimit për ndërtimin e kapaciteteve të prodhuesve kosovarë për të qenë partnerë dhe konkurrues në tregjet ndërkombëtare.

Formalizohet aplikacioni i parë 30 milionësh për investime strategjike në fushën e minierave



PRISHTINË, 11 DHJETOR (ER) - Ministri i Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Dardan Gashi, ka pranuar aplikacionin e parë të investitorëve strategjikë në fushën e minierave. Konsorciumi i përbërë nga Moxico Resources (Angli), Pluto Investment AG (Zvicër) dhe Luma Investment

SA (Poloni) kanë dorëzuar të zëvendëskryeministri dhe ministri i Diasporës dhe Investimeve Strategjike aplikacionin për statusin e investitorit strategjik.

Në një takim të mbajtur në zyrat e Ministrisë së Diasporës, përfaqësuesit e këtij konsorciumi, i cili ka mbi 20 mijë punë-

torë në operacionet e saj në botë, u shprehën të kënaqur me përkrahjen e ofruar si nga MDIS, MTI ashtu edhe KIESA. Ministri Gashi u zotua se kjo përkrahje do të vazhdojë edhe në fazat vijuese. "Ne, bazuar në zotimet tona si institucione, do të jemi të gatshëm të ofrojmë ndihmë të rezervë për pë-

shpejtimin dhe thjeshtimin e procedurave administrative dhe teknike të nevojshme, ashtu që ky projekt, i cili ka vlerë mbi 30 milionë euro, të fillojë sa më shpejt", ka thënë ministri Gashi.

Konsorciumi britanik-zviceran-polak është përqendruar në zhvillimin e biznesit në sek-

torin e minierave, respektivisht në tri zonat me interes kombëtar në Komunën e Mitrovicës dhe Vushtrrisë, përkatësisht në Karaçë, Vllahi dhe Gumnishtë. Ky projekt jo vetëm se do ta zhvillojë sektorin minerar të Kosovës, por do ta nxisë edhe zhvillimin lokal dhe të komunitetit në këto zona.

Rriten çmimet e konsumit

PRISHTINË, 11 DHJETOR (ER) - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar "Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit" (IHÇK) për muajin nëntor të vitit 2018, me vit bazë 2015=100.

Inflacioni mujor i matur nga indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit ishte 0.7 për qind në nëntor të 2018-s, që do të thotë se indeksi i tërësishëm ishte më i lartë, krahasuar me muajin tetor të këtij viti. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit të nëngrupet e COICOP-it: bukë dhe drithëra (4.2 për qind); qumësht, djathë dhe vezë (0.6 për qind); vajra dhe yndyra (1.1 për qind); perime (3.5



për qind); sheqer, reçel, mjaltë, çokolatë dhe ëmbëlsira (1.1 për qind); dru zjarri për ngrohje (3.6 për qind); pajisje audio-vizuale, fotografike për përpunimin e

informative (1.4 për qind), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 0.8 për qind në IHÇK.

Ngritja u neutralizua nga rënia e

çmimeve të konsumit të nëngrupi i pemëve (-4.0 për qind) me një ndikim të këtij nëngrupi prej (-0.1 për qind) në IHÇK. Ndërkaq, shkalla vjetore e inflacionit, e matur në muajin nëntor të 2018-s me muajin nëntor të 2017-s, ishte 2.1 për qind. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë të nëngrupet e COICOP-it: bukë dhe drithëra (5.0 për qind); mish (4.6 për qind); qumësht, djathë dhe vezë (1.1 për qind); perime (12.3 për qind); pije alkoolike (3.0 për qind); duhan (2.8 për qind); përdorim të pajisjeve për transportin personal (11.5 për qind) (ngritje e çmimit të naftës dhe benzinës),

shërbimet për transport (6.3 për qind) (ngritje e çmimeve të biletave të transportit ajror), shërbimet hoteliere (2.3 për qind), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 2.8 përqindësh në IHÇK. Ngritja u neutralizua kryesisht nga rënia e çmimeve të konsumit të nëngrupet e COICOP-it: pemë (-11.8 për qind); sheqer, reçel, mjaltë, çokolatë dhe ëmbëlsira (-4.5 për qind), ujë mineral, pije joalkoolike, lëngje nga pemët dhe perimet (-1.4 për qind); energji elektrike, gaz dhe lëndë djegëse të tjera (-5.8 për qind), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej (-0.7 për qind) në IHÇK.

Zgjatet afati për implementim të projekteve për zhvillim rural 2018

PRISHTINË, 11 DHJETOR (ER) - Me udhëzimin administrativ të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) Nr. 18/2018 është bërë plotësim-ndryshimi i udhëzimit administrativ Nr. 05/2018 për masat dhe kriteret e përkrahjes për Zhvillim Rural për vitin 2018. Lajmin e ka bërë me dije zëvendëskryeministri

në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Mevludin Krasniqi. Ky plotësim-ndryshim i udhëzimit administrativ mundëson zgjatjen e afateve për implementimin e projekteve të miratuara në masat: Masa 101 (investimet në asetet fizike në ekonominë bujqësore): afati prej 90 ditësh zgjatet në 120

ditë; afati prej 120 ditësh zgjatet në 210 ditë. Masa 302 (diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve): afati prej 90 ditësh zgjatet në 180 ditë; afati prej 90 ditësh zgjatet në 180 ditë. Masa (ujitja e tokave bujqësore): afati prej 180 ditësh zgjatet në 270 ditë; afati prej 180 ditësh zgjatet në 270 ditë.



Në UKZ mbahet sesioni informues për programin Global UGRAD 2019-2020

Gjilan, 11 dhjetor (ER) - Zyrtarë nga Zyra Amerikane në Kosovë, para studentëve të Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan, kanë mbajtur sesion informues rreth Programit Global të Shkëmbimit Studentor (Global UGRAD) 2019-2020 që sponsorizohet nga Zyra Amerikane e Shtetit për Çështjet Arsimore dhe Kulturore.

Erin Molnar Mains, zëvendës-drejtor në Sektorin për Marrëdhënie me Jashtë nga Zyra Amerikane e Shtetit për Çështjet Arsimore dhe Kulturore, ka thënë se ky program ofron bursa të financuara plotësisht për një semestër të studimeve akademike jodiplomike për studentët e Universitetit "Kadri Zeka" në një kolegji ose universitet të cak-

tuar të SHBA. Sipas saj, gjatë programit pjesëmarrësit Global UGRAD sfidojnë veten për ta shqyrtuar shoqërinë amerikane, kulturën dhe të mësuarit akademik, ku njëherësh kanë rastin të marrin pjesë në shërbimin e komunitetit dhe t'i rrisin aftësitë e tyre profesionale.

Kurse Remzije Potoku nga zyra Amerikane në Kosovë ka thënë se aplikimi për pjesëmarrje në Programin Global UGRAD 2019-2020 është i hapur, ndërsa do të mbyllet më 31 dhjetor në orën 17:00. Edhe të pranishmit patën interesime të ndryshme rreth programit në fjalë. Për informacionin e aplikimit dhe udhëzimet, ju lutemi vizitoni aplikacionin Global UGRAD online.



Drejtuesit komunalë të Mitrovicës priten në takim përfaqësueset e projektit DEMOS

MITROVICË, 11 DHJETOR (ER) - Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Shukri Gashi, së bashku me drejtorin e Administratës, Hysen Muzliukaj, si dhe koordinatoren për performancë komunale, Mehmet Bajramin, kanë pritur të martën në takim dy përfaqësueset e projektit të DEMOS-it (Helvetija), Ilire Daija-Buza dhe Shqiponja Vokshi. Qëllimi i këtij takimi ishte bisedimi lidhur me indikatorët e performancës, rreth formave të bashkëpunimit për një performancë më të mirë. Mehmet Bajrami, koordinator për

performancë komunale, ka falënderuar përfaqësueset e projektit DEMOS për mbështetjen që po ua japin komunave të Kosovës, përfshirë këtu edhe Komunën e Mitrovicës. "Komuna e Mitrovicës, me performancën komunale për vitin 2018, qëndron më mirë krahasuar me vitet para-prake. Ajo ka qenë përfituese e grandit edhe në vitin 2016, ndërsa për vitin 2017 komuna ka arritur të fitojë grand në shumën prej 76 525 eurosh", ka thënë koordinatori Bajrami. Gjithashtu, përfaqësueset e DEMOS-it njoftuan se shumë

shpejt do të fillojë trajnimi për formën e re online të performancës, ndërsa gjatë vitit 2019 do të fillojnë trajnimet për zyrtarët komunalë përgjegjës të cilët do të merren me përmirësimin e indikatorëve dhe të treguesve të performancës.

Në fund të takimit përfaqësueset e DEMOS-it, së bashku me koordinatoren për performancë komunale, Mehmet Bajrami, kanë vizituar edhe parkun te varrezat ortodokse, në hyrje të qytetit, projekt ky i realizuar falë grandit të performancës së vitit 2016.



Komuna e Rahovecit vazhdon aksionin 'Ta pastrojmë Kosovën'

Rahovec, 11 dhjetor (ER) - Në kuadër të fushatës "Ta pastrojmë Kosovën", Komuna e Rahovecit sot ka vazhduar aktivitetin për largimin e mbeturinave. Aksionit për largimin e mbeturinave u është bashkuar edhe kryetari i

komunës, Smajl Latifi, organizata mjedisor "Ta pastrojmë Kosovën", qytetarë të shumtë dhe nxënës të shkollave. "Qëllimi i këtij aksioni është sensibilizimi dhe krijimi i një praktike te qytetarët, se hedhja e mbeturinave shkatërron

mjedisin dhe shëndetin tonë. U bëj thirrje qytetarëve ta rrisin vetëdijen për kujdesin ndaj mjedisit dhe institucionet të vazhdojnë gjobitjen e ndotësve në bazë të legjislacionit në fuqi", ka thënë kryetari Latifi.

Bujar Gashi, drejtor i Shëndetësisë në Komunën e Prishtinës

PRISHTINË, 11 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka bërë me dije të martën se ka emëruar drejtor të Shëndetësisë në Komunën e Prishtinës, Bujar Gashin. Ai ka thënë se Gashi është specialist i mjekësisë familjare dhe trajner i akredituar për Mjekësi Familjare. "Në vitin 2016 e kemi zgjedhur drejtor të Qendrës së Mjekësisë Urgjente

në Prishtinë dhe që nga ajo kohë ka treguar rezultate të matshme në fushën e urgjencës dhe menaxhimit shëndetësor. Bazuar në rezultatet në punë dhe njohjen e Shëndetësisë Primare në komunën tonë, dr. Bujari është zgjedhja e duhur për ta vazhduar reformën në shëndetësinë primare në Prishtinë", ka thënë Shpend Ahmeti, kryetar i Komunës së Prishtinës.



BE-ja duhet ta heqë logjikën e dyfishtë dhe matjen me dy kute!

Vetëm duke ndenjur neutrale ndaj "çështjes së taksës" dhe duke kërkuar që sikur të gjitha çështjet e tjera, "edhe ky problem të zgjidhet në kuadër të dialogut Kosovë - Serbi", BE-ja mund ta luajë rolin e ndërmjetësuesit të paanshëm dhe t'ia heqë vetes logjikën e matjes me dy kute.



Bilall SHERIFI

Duke folur para gazetarëve në "Konferencën e pranimit ministror BE - Serbi", komisionari evropian për Zgjerim dhe Fqinjësi të Mirë, Johannes Hahn, deklaroi se "taksa prej 100 përqindësh për mallrat e importuara nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina është kundër frymës së tregtisë së lirë të CEFTA-s dhe kundër frymës së bashkëpunimit rajonal, i cili mund të zhvillohet vetëm nëpërmjet tregtisë së lirë, lëvizjes së lirë të mallrave dhe lëvizjes së lirë të

njerëzve".

Që nga koha kur BE-ja ka marrë rolin e ndërmjetësuesit në bisedimet Kosovë - Serbi nuk kemi pasur një kontekst të tillë që mundësoi nxjerrjen në shesh të logjikës së dyfishtë të sjelljes nga ana e disa përfaqësuesve të BE-së. Vendosija e taksave për produktet e Serbisë dhe të Bosnjës e Hercegovinës shërbeu për të përdorur një mori formash të presionit ndaj Kosovës, duke na i kujtuar parimet themelore dhe vlerat mbi të cilat mbështetet BE-ja.

Meqenëse jemi te parimet dhe vlerat që mishërojnë institucionet e BE-së dhe spekulohet rreth asaj se kush i shkel këto parime, atëherë po rikujtoj me sa vijon: Të gjitha ankesat që janë bërë nga ana e Kosovës për mosrespektimin e marrëveshjeve të nënshkruara në Bruksel kanë gjetur një trajtim

mospërfillës nga ana e Serbisë; kur autoritetet e Kosovës kërkonin nga institucionet e BE-së të ndërhynin tek autoritetet e Serbisë për ta respektuar marrëveshjen për energji, përgjigja ishte e qartë: "problemet të zgjidhen në kuadër të dialogut Kosovë - Serbi"; kur autoritetet e Kosovës kërkonin nga institucionet e BE-së të ndërhynin tek autoritetet e Serbisë për ta ndërprerë minimin e përpjekjeve të Kosovës për anëtarësim në institucionet dhe organizatat ndërkombëtare, përgjigja ishte e njëjtë: "problemet të zgjidhen në kuadër të dialogut Kosovë - Serbi"; kur autoritetet e Kosovës kërkonin nga institucionet e BE-së të ndërhynin tek autoritetet e Serbisë për ta ndërprerë financimin e strukturave ilegale në Kosovë, përgjigja e njohur na nxirrej përpara: "problemet të zgjidhen në kuadër të dialogut Kosovë - Serbi"; kur autoritetet e Kosovës kërkonin nga institucionet e BE-së të ndërhynin tek autoritetet e Serbisë për t'i ndërprerë presionet ndaj pjesëtarëve të përkatësisë etnike serbe në institucionet e Kosovës, kishim përgjigjen tanimë të njohur: "problemet

të zgjidhen në kuadër të dialogut Kosovë - Serbi"; kur autoritetet e Kosovës kërkonin nga institucionet e BE-së të ndërhynin tek autoritetet e Serbisë për t'i hequr barrierat që u vendoseshin produkteve dhe ndërmarrjeve të Kosovës, kërkohej nga Kosova që "problemet të zgjidhen në kuadër të dialogut Kosovë - Serbi"; kur autoritetet e Kosovës kërkonin nga institucionet e BE-së të ndërhynin tek autoritetet e Serbisë për t'i respektuar parimet për lëvizjen e lirë të mallrave, lëvizjen e lirë të mjeteve dhe lëvizjen e lirë të njerëzve nga Kosova, na thuhej që "problemet të zgjidhen në kuadër të dialogut Kosovë - Serbi". Me një fjalë, sa herë që autoritetet e Kosovës kërkonin nga institucionet e BE-së të ndërhynin tek autoritetet e Serbisë për t'i respektuar marrëveshjet, përfaqësuesit e BE-së e përsëritnin të njëjtën gjë: "problemet të zgjidhen në kuadër të dialogut Kosovë - Serbi". Autoritetet e Kosovës u kanë bërë me dije të gjitha institucioneve ndërkombëtare dhe shteteve veç e veç, se taksa e vendosur për produktet e Serbisë dhe Bosnjës e Hercegovinës është çështje që

mund të zgjidhet vetëm në kuadër të pakos së përgjithshme të dialogut Kosovë - Serbi.

Vetëm duke ndenjur neutrale ndaj "çështjes së taksës" dhe duke kërkuar që sikur të gjitha çështjet e tjera, "edhe ky problem të zgjidhet në kuadër të dialogut Kosovë - Serbi", BE-ja mund ta luajë rolin e ndërmjetësuesit të paanshëm dhe t'ia heqë vetes logjikën e matjes me dy kute.

Në kohën kur Kosova i plotësoi të gjitha kushtet për heqjen e regjimit të vizave ndaj qytetarëve të Kosovës, getoizimi i qytetarëve të Kosovës nuk është në frymë të bashkëpunimit rajonal dhe as në përputhje me parimin për qarkullimin e lirë të njerëzve, ideve dhe mallrave që qëndron në themelet e vlerave demokratike.

Do të kishte qenë mirë që komisionari Johannes Hahn dhe të gjithë përfaqësuesit e tjerë të BE-së që kanë ndjekur angazhimet e Kosovës në këtë proces, të angazhohen për të dëshmuar se edhe në rastin e Kosovës BE-ja funksionon në përputhje me parimet e veta. Deri tani realiteti dëshmon logjikën e dyfishtë dhe matjen me dy kute!

Përdorimi i fishekzjarrëve, i rrezikshëm, sidomos për fëmijët

Në Kosovë një numër i madh i fishekzjarrëve që tregtohen janë jashtë standardeve të kërkuara dhe mund të jenë të rrezikshme gjatë përdorimit andaj, duke marrë parasysh se në të shumtën e rasteve personat që i shpërthejnë këto mjete piroteknike janë të miturit dhe fëmijët, duhet të apelohej për kujdes jashtëzakonisht të madh, sepse materialet piroteknike (fishekzjarrët), në rast se nuk përdoren në kohën dhe vendin e duhur, përbëjnë rrezik për lëndime serioze



Shkruan: Tahir AHMETI

Me afrimin e festave të fundvitit fillojnë edhe përgatitjet për festimin e tyre. Fishekzjarrët dhe mjetet e tjera piroteknike janë pa dyshim një mënyrë e bukur për

t'i shënuar çastet kulmore të këtyre festave, megjithatë, përtej atmosferës së jashtëzakonshme që krijojnë, ato janë të rrezikshme për shëndetin, pasi mund të bëhen burim aksidentesh dhe dëmtimesh si djegie, shurdhime, njëkohësisht shkaktojnë edhe ndotje akustike dhe ndotje të ambientit.

Në Kosovë një numër i madh i fishekzjarrëve që tregtohen janë jashtë standardeve të kërkuara dhe mund të jenë të rrezikshme gjatë përdorimit andaj, duke marrë parasysh se në të

shumtën e rasteve personat që i shpërthejnë këto mjete piroteknike janë të miturit dhe fëmijët, duhet të apelohej për kujdes jashtëzakonisht të madh, sepse materialet piroteknike (fishekzjarrët), në rast se nuk përdoren në kohën dhe vendin e duhur, përbëjnë rrezik për lëndime serioze.

Institucionet relevante, respektivisht Ministria e Punëve të Brendshme, duhet që në prag të këtyre festave në kohë reale të ndër marrë fushata informuese /senibilizuese, në mënyrë që

qytetarët të jenë të njoftuar për rrezikun që paraqesin këto mjete piroteknike, ndërsa komunitat, siç edhe kanë vepruar disa prej tyre në vitet e fundit, duhet që gjatë kohës së këtyre festave ta ndalojnë me urdhëresë për një periudhë të caktuar kohore përdorimin e produkteve piroteknike, në vendet e hapura publike, përkatësisht në tregje, rrugë dhe sheshe, për shkak të sigurisë së qytetarëve dhe si një preventivë mjaft e qëlluar në mënyrë që të evitohet rreziku nga përdorimi i tyre, kurse gjithë ata që veprojnë në kundërshtim me urdhëresën, duhet të gjobiten.

Si këshilla të dobishme në lidhje me përdorimin e këtyre mjeteve piroteknike mund të ceken disa prej tyre:

Asnjëherë të mos përdoren fishekzjarrë në ambiente të mbyllura (shtëpi, lokale, bare,

zyra dhe klasa shkolle);

Të mbahen fëmijët larg mjeteve piroteknike, ruani veten dhe të tjerët, udhëzoni fëmijët të mos përdorin fishekzjarrët si lojë, pasi mund të dëmtohen rëndë; Asnjëherë të mos ndizen fishekzjarrë brenda sendeve të forta e të mbyllura, si gota e shishe qelqi, kuti metalike etj; Mos të lejohen fëmijët të luajnë me fishekzjarrë apo t'i ndezin ato, të paktën jo pa praninë e personave të rritur; Asnjëherë të mos mbani fishekzjarrë në xhepa; Asnjëherë të mos i vendosni ato në pjesë të trupit kur i ndizni, por mbajini në një distancë të sigurt.

(Autori është njohës i çështjeve të emergjencave dhe bashkëthemelues i Qendrës Kërkimore për Politika të Sigurisë - SPRC)

150 vende miratojnë paktin e OKB-së për emigrimin

MAROK, 11 DHJETOR - Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Antonio Guterres, tha se emigrimi i njerëzve "duhet menaxhuar mirë dhe duhet të jetë i sigurt. Ai nuk duhet të jetë një proces i çrregullt dhe i rrezikshëm". Guterresi vlerësoi një grup prej 150 vendesh, për miratimin e një pakti, që synon përmirësimin e mënyrës së trajtimit të emigrantëve. Këto komente Guterres i bëri në fillim të një konference dyditore për emigra-

cionin, që po mbahet në Marrakech të Marokut. Marrëveshja "Global Compact" ka 23 objektiva, mes tyre krijimin e shërbimeve bazë, shtimin e përpjekjeve kundër trafikimit të emigrantëve, eliminimin e diskriminimit të tyre, krijimin e kushteve të sigurta dhe të favorshme për kthimin e tyre të sigurt dhe me dinjitet për në shtëpitë e tyre, në rastet kur ata urdhërohen të kthehen. Pakti nuk ka ende detyrim ligjor. Marrëveshja u negociua gjatë

një procesi dyvjeçar dhe ShBA-ja ishte vendi i parë që doli prej saj dhjetorin e kaluar, me argumentin se ajo "nuk u përshtatej politikave të emigracionit dhe të refugjatëve" të Shteteve të Bashkuara. Pas ShBA-së, nga marrëveshja kanë dalë edhe vende të tjera, si Australia, Austria, Hungaria, Letonia, Polonia dhe Republika Dominikane. Guterres tha se më tepër se 60 mijë imigrantë kanë humbur jetën gjatë përpjekjeve për të



kaluar në mesin e shkretëtirave, oqeanëve dhe lumenjve. OKB-ja vlerëson se numri i emigrantëve

në botë është rreth 258 milionë veta, rreth 3 për qind e popullsisë së botës.

Kandidatët e mundshëm për ta pasuar Theresa Mayn

Ish-kryebashkiaku i Londrës, Boris Johnson, ish-bankieri Sajid Javid, ish-deputetja Amber Rudd dhe Michael Gove konsiderohen se do të jenë pretendentët kryesorë për postin e kryeministrit të Britanisë së Madhe në rast të dështimit të Brexitit dhe rënies së Qeverisë britanike



LONDËR, 11 DHJETOR - I lidhur ngushtë me marrëveshjen e Brexitit, fati i kryeministres konservatore Theresa May mund të lëkundet nga njëra ditë në tjetrën. Por, kush janë pretendentët kryesorë për postin e kryeministrit.

Boris Johnson, rivali i përjetshëm, ish-kryebashkiaku i Londrës, ishte një nga arkitektët kryesorë të fitores së Brexitit në referendumin e qershorit 2016. Ai u emërua ministër i Jashtëm nga Theresa May, por kjo gjë nuk e pengoi aspak për ta kritikuar strategjinë e saj në negociatat me Brukselin, para se të jepte dorëheqje në korrik, duke u bërë një nga kundërshtarët më të ashpër në mesin e konservatorëve. Karizmatik, popullor dhe politikan i shkëlqyer, "Bojo", 54 vjeç, shquhet për një personalitet që nxit debate. I pyetur së fundmi nga BBC-ja për ambicjet e tij, ky mbështetës i një divorci pa kompromis i është shmangur pyetjes.

Sajid Javid, konsensual, një ish-bankier dhe djali i një shoferi autobusi me origjinë pakistaneze, Sajid Javid, 49 vjeç, imazhi i një Britanie të Madhe moderne dhe multikulturore, është një udhëheqës me ndikim i Partisë Konservatore. Vetëm për pak muaj në krye të

Ministrisë së Brendshme ai arriti ta imponojë stilin e tij dhe të fitojë respektin e deputetëve konservatorë. Mbështetës i filozofisë theçeriane dhe tregut të lirë, ky ish-euroskeptik doli kundër Brexitit në referendum. Amber Rudd, trashëgimtarja, u zgjodh deputete në vitin 2010 pas një karriere në financë dhe gazetari ekonomike. Ajo shoqëroi Theresa May në rrugëtimin drejt pushtetit, mbështetje për të cilën ajo u shpërblye me postin e ministres së Brendshme dhe më pas atë të Punës. E njohur si person i palodhur dhe shumë eficient, Amber Rudd, 55 vjeçe, u përzgjedh "Ministria e vitit 2015" nga revista konservatore "The Spectator" për punën e saj në krye të Ministrisë së Energjisë.

Një pikë e dobët? Reputacioni i tij si eurofile, i cili mund t'i shërbejë si pengesë gjatë fushatës për t'u zgjedhur kryeministria e ardhshme. Michael Gove, hipokrit, marrja e postit të kryeministrit nuk do të ishte e para për Michael Gove, 51 vjeç, i cili mori përsipër riskun në valën e referendumit të vitit 2016.

Ministri i Mjedisit dhe një kritik i ashpër i materialeve plastike, ky euroskeptik, krahu i djathtë i Boris Johnsonit gjatë fushatës

së referendumit, është një nga garancitë kryesore pro Brexitit të qeverisë së May.

David Davis, me shumë përvojë, 69-vjeç, ishte ministri i parë i Brexitit, një post i krijuar në vitin 2016 për të vënë në zbatim daljen nga BE-ja dhe për të negociuar me Brukselin.

Ky euroskeptik i bindur, i cilësuar dembel, dha dorëheqje me zhurme në korrik, së bashku me Boris Johnson, me arsyetimin për një Brexit shumë të butë propozuar nga Theresa May.

Dominic Raab, ujku i ri, "gjithmonë jam shprehur se nuk e përjashtoj si mundësi", përgjigjet deputeti ultraliberal 44-vjeçar kur i bëhet pyetja nëse dëshironte ta merrte përsipër drejtimin e ekzekutivit.

Mbështetës i flaktë i largimit nga BE-ja, fitues i rripit të tretë në karate, një ish-avokat i specializuar në të drejtën ndërkombëtare, ishte për një kohë të shkurtër ministër i Brexitit mes korrikut dhe nëntorit, para se të jepte dorëheqje në mosmarrëveshje me traktatin e negociuar me BE-në që ai e gjykon të keq për ekonominë dhe demokracinë britanike.

Jeremy Hunt, brexiteri ri, ministër i Jashtëm, 52-vjeçar, mbështeti qëndrimin në BE në 2016-n, përpara se të ndryshonte mendim, i zhgënjyer nga qasja "arrogante" e Brukselit në negociata. Një ish-biznesmen që flet rrjedhshëm gjuhën japoneze, që ka skalitur një reputacion si individ, që

nuk u trembet sfidave, pasi drejtoi për gjashtë vjet Shërbimin Publik Shëndetësor (NHS), i ballafaquar me një krizë të thellë. Konkurrent, me mundësi të pakta për ta fituar garën.

Penny Mordaunt, figurë në ngjitje e konservatorëve, ministre e Zhvillimit Ndërkombëtar, 45 vjeçe, në një postim të fundit në internet kritikon mungesën e leadershipit në krye të vendit.

Esther McVey, ish-ministre e Punës, 51-vjeçe, u largua nga qeveria në nëntor, e zhgënjyer nga marrëveshja e negociuar me BE-në. "Nëse qytetarët do të ma kërkonin, sigurisht se do të mendoja seriozisht një gjë të tillë", tha ajo për postin e kryeministrit.


Putini komenton arrestimin e Maria Butinës në ShBA

MOSKË, 11 DHJETOR - Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, tha se është e paqartë se përse një ruse me emrin Maria Butina ishte arrestuar në Shtetet e Bashkuara dhe akuzohet si agjente e Rusisë, ndërkohë që shefat e tij të zbulimit i kanë thënë se nuk dinë asgjë

për të. Butina dyshohet se po përpiqej të depërtonte në Shoqatën Kombëtare të Armëve dhe të ndikonte në politikën amerikane ndaj Rusisë. Ajo pritet ta pranojë fajësinë këtë javë pas një marrëveshjeje mes avokatëve të saj

dhe prokurorëve amerikanë, sipas dokumenteve të gjykatës. Butina, e cila u arrestua në korrik, do të paraqitet në një gjykatë të Uashingtonit sot (e mërkurë), edhe pse veprat penale për të cilat ajo pritet të vetëshpallet fajtoare nuk janë bërë të ditura.

Departamenti Amerikan i Drejtësisë thotë se Butina ishte një "agjente e fshehtë ruse" që mbante lidhje me spionë rusë në një mision që synonte të depërtonte në aparatën vendimmarrëse kombëtare të ShBA-së në interes të Federatës Ruse.



Lahuta, Eposi i Kreshnikëve dhe UNESCO sot

Zymer U. NEZIRI

Po, ishte lajm i keq ky i tashmi, për regjistrimin e nominimit të lahutës si pasuri serbe në UNESCO. Ndonëse ajo e ka vendin aty, në UNESCO, nuk është edhe pasuri vetëm e një populli. Vlerësuesit e projektit kanë vepruar edhe politikisht në sesionin e 13-të të Komitetit Ndërqeveritar për Ruajtjen e Trashëgimisë Jomateriale, ose kanë qenë të lajthitur, lidhur me lahutën ndër-kulturore, por jo edhe me këngën serbe, ku u bë regjistrimi i nominimit të projektit "Të kënduarit në shoqërimin e lahutës", paraqitur nga Serbia, në Listën Përfaqësuese të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale të Njerëzimit.

Pra, lahuta nuk është instrument muzikor vetëm i serbëve. Janë disa popuj që sot e përdorin lahutën, me disa dallime nga njëra-tjetra. Lahuta, si vegël e vjetër kordofone me një tel, ka pasur përhapje në Evropë e jashtë Evropës. Dëshmi janë edhe emrat e saj në gjuhët e disa popujve evropianë dhe aziatikë. Por, meritore duhet të konsiderohet fjala e ekspertëve të veglave muzikore popu-llore.

Shqiptarët e përdorin lahutën në pesë shtete të Ballkanit: Shqipëri, Kosovë, Maqedoni Perëndimore, si dhe në viset shqiptare në Serbi e në Mal të Zi, sidomos për shoqërimin e këngëve të Eposit të Kreshnikëve, kryevlerë e gjallë e krijimtarisë gojore shqiptare dhe evropiane.

Lahutën e kanë vlerësuar edhe etnomuzikologët tanë të njohur, Ramadan Sokoli, Rexhep Munishi, Pirro Miso, Vasil Tole, Nikolla Skalldaferi (Nicola Scaldaferrri), epikologët Maksimilian Lambert (Maximilian Lambert), Millmen Peri (Milman Parry), Allbert Llord (Albert Lord),

Ernest Koliqi, Qemal Haxhihasani, Anton Çetta, Veis Sejko, Enver Mehmeti, Dejvid Ellmer (David Elmer), Agron Xhagolli, Shaban Sinani, Rigels Halili etj.

Te shqiptarët, nderimi për lahutën është i madh. Ekziston edhe kulti ndaj lahutës. Dhe, ajo zbukurohet me gdhendjen e figurave të njohura mitike nga periudha e Antikës, e kul-teve ilire të gjarprit dhe të kokës së dhisë. Zbukurimi i saj bëhet edhe me figura të njohura historike të periudhës së Mesjetës, me por-tretin e gdhendur të Gjergj Kastriotit, për të shtuar krenarinë e dëgjuesve të këngëve epike me bëmat e famshme të fitoreve të popullit shqiptar, para rreth gjashtë shekujsh, me Skënderbeun në krye. Ajo zbukurohet edhe me flamurin kombëtar, ose me portrete të figurave të shquara të dy shekujve të fundit, nga Rilindja e deri te UÇK-ja dhe Adem Jashari. Ajo e ka vendin më të rëndësishëm në odën e burrave. Varej mbi oxhak dhe asgjë tjetër nuk varej mbi të.

Lahutarët tanë kanë kënduar edhe mbi dhjetë mijë vargje të kreshnikëve. Në Arkivin e Institutit Albanologjik të Prishtinës ruhet fondi i dy lahutarëve të tillë rugovas, forma e kënduar dhe shkri-more, në vitet '80 të shekullit të kaluar, Haxhi Meta-Nilaj dhe Isuf Selmani-Kuklecaj, që kishin në repertor mbi 10 mijë vargje. Lahutarë të mëdhenj ishin edhe Sokol Martini (Mërtur), Shaban Groshi (Rugovë) e Gjakë Nonaj (Lezhë). Hapave të tyre kanë vazhduar Isë Elezi-Lekë-gjekaj (Rugovë), Rrok Prenkoçaj (Malësi e Madhe), Fehmi Rama-Nishefci (Gallap), Kadri Zymeri (Karadak) etj. Fondi arkivor i këngëve të kreshnikëve, në Tiranë, Prishtinë, Harvard etj. është rreth 600 mijë vargje (1897-2016).



Fatkeqësisht, vetëm në Prishtinë, në IAP, janë 27 vël-lime të pa botuara (Fondi ZUN).

Interesim kanë treguar edhe studiuesit e Universitetit të Harvardit, që nga vitet '30 të shekullit të kaluar, për lahutarët tanë të Sanxhakut të Pazarit, të Rugovës, të Plavës e të Gucisë, të Malësisë së Madhe, të Dukagjinit, të Nikajve e të Merturit, të Malësisë së Gjakovës, të Rrafshit të Dukagjinit etj. Për këto këngë janë shkruar disa disertacione doktoratash në Padovë, Columbia (Nju-Jork), Harvard (Kembrixh), Prishtinë, Tiranë, Varshavë etj. Nga Harvardi e deri në Pekin janë mbajtur ligjëratat ose kumtesa për to. Janë shkruar qindra studime, e ndër to janë mbaj-

tur mbi 200 kumtesa vetëm në tri konferenca shkencore ndërkombëtare për këto këngë epike heroike legjendare, në krye me Gjeto Basho Mujin dhe Sokol Halil Agën: Tiranë (1983) dhe në Prishtinë (2010 e 2014). Eposi i Kreshnikëve sot është ndër të vetmet epose heroike të gjalla në epikën evropiane. Se këto këngë jetojnë, kur shumë epika të mëdha të Evropës janë shuar, kjo u dëshmuar edhe me projektin tonë hulumtues shkencor E5, 2012-2016, në Ballkan, që solli 15 vël-lime të reja të Eposit të Kreshnikëve në arkivin e fondit kombëtar, nga rreth 300 rap-sodë e regjistrime në pesë shtete të Ballkanit. Projekti u vlerësua nga Europa Nostra në Madrid, në maj 2016, me Mendim Special, në kategorinë

hulumtim.

Ky projekt është pjesë e Dosjes për nominimin e këtyre këngëve në UNESCO, në Listën Përfaqësuese të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale të Njerëzimit.

Dosja qeveritare e kryer e Eposit të Kreshnikëve, në fillim të vitit 2013, e planifikuar më 2008 dhe e nisur më 2009 në Institutin Albanologjik të Prishtinës, u realizua nga ekipi i ekspertëve të Prishtinës dhe të Tiranës, akad. i asoc. prof. dr. Shaban Sinani, akad. prof. dr. Vasil Tole dhe prof. dr. Zymer Neziri (kryesues), por nuk u dorëzua në UNESCO, para afër 6 vjetësh. Dosja i ka të gjitha argumentet se Eposi i Kreshnikëve duhet të shpallet vlerë e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale të Njerëzimit në UNESCO, kurse institucionet tona duhet të punojnë bashkë edhe në projekte të tjera të trashëgimisë jomateriale për UNESCO, siç janë gjama e burrave, xhubleta, fustanella, disa veshje krahinore të Veriut e të Jugut, disa valle epike e lirike etj.

Dorëzimin qeveritar të Dosjes qeveritare të Eposit të Kreshnikëve duhej ta bënte Tirana, më 2013, me pëlqimin qeveritar të Prishtinës, por pëlqimin nuk e pati. Kosova as sot nuk e ka statusin e anëtarit në UNESCO, prandaj atje nuk shkon dot as tash me Tiranën së bashku. Por, as tash nuk është vonë që këtë ta bëjë Tirana, me pëlqimin qeveritar të Prishtinës, së cilës nuk bën t'i mohohet assesi kjo e drejtë, sepse është pasuri e përbashkët e kombit shqiptar.

Pra, nga ky lajm i keq për regjistrimin e lahutës në UNESCO si pasuri serbe e trashëgimisë kulturore të njerëzimit, besoj shumë se ministrinë tona të Kulturës, në Tiranë e në Prishtinë, edhe institucionet përkatëse tashmë kanë marrë mësim të mirë.

Ministri Gashi: Fuqizimi i rinisë, fokusi ynë

PRISHTINË, 11 DHJETOR (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka pritur të martën në kabinetin e vet përfaqësues të organizatës World Vision në Kosovë. Në këtë takim në mes të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe organizatës "World Vision" u nënshkrua një memorandum bashkëpunimi.

Qëllimi i këtij memorandum është angazhimi i ndërsjellë i MKRS-së dhe WVK-së për zbatimin e strategjive kombëtare që kanë në fokus të rinjtë. Organizata "World Vision" në Kosovë angazhohet që, sipas

drejtimeve strategjike të saj, ta zbatojë Programin e Rinisë dhe Programin e Fuqizimit Ekonomik të Rinisë, të cilat janë në përputhje me objektivat e strategjive kombëtare.

Po sipas këtij memorandum, "World Vision" bashkëpunon me partnerët kombëtarë e lokalë dhe institucionet shtetërore për zbatimin e programeve të saj në lidhje me mirëqenien dhe zhvillimin e të rinjve në këto komuna të Kosovës: Prizren, Rahovec dhe Suharekë, Gjakovë dhe Malishevë, Lipjan dhe Graçanicë, Mitrovicë, Vushtrri dhe Ferizaj.



Ministri Kujtim Gashi u shpreh shumë i kënaqur me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje. Ai ka thënë se kjo marrëveshje përkufizon qëllimin dhe vull-

netin e dyanshëm për të bashkëpunuar. "Ky bashkëpunim do të zgjasë për një periudhë pesëvjeçare dhe do të konsistojë në zbatimin e disa

projekteve në fushën e fuqizimit të të rinjve, zhvillimit ekonomik", ka thënë Gashi.

Ai ka theksuar se projektet që do të realizohen në mënyrë specifike mbështesin fuqizimin e të rinjve të moshave 18-24 vjeç nëpërmjet trajnimeve dhe aktiviteteve që synojnë përmirësimin e aftësive për jetën, krijimin e një mjedisi mbështetës për të rinjtë me anë të rritjes së ndërgjegjësimit të komuniteteve për rëndësinë e pjesëmarrjes aktive dhe domethënësia të të rinjve në jetën sociale dhe ekonomike të një komuniteti.

E jashtëzakonshme

Delja që urren të qethet

Kohët e fundit kemi parë shumë kafshë të pazakonta në shtete të ndryshme të botës, por nuk e dinim se ekzistonte delja që quhet "Shrek", e cila e urren qethjen. Kafsha u qeth për herë të parë para disa muajsh pasi u gjet në një shpellë ku u fsheh për gjashtë vjet. Qethjen e saj të parë e realizoi mbajtësi i rekordit botëror, Peter Casserly, në Muzeun Kombëtar të Deleve. Pasi nxori lesh për 20 kostume meshkujsh,



ai tha se do ta çonte rastin e "Shrekut" në librin "Guinness".

FOTO E DITES



Refugjatët afganë duke ngrënë ushqim pasi u dëbuan nga oficerët e ushtrisë greke. /AFP/

E rrallë

Një buton i shtypur gabim i kushton "Google"-s 10 milionë euro

Një gabim i kryer nga një praktikant i kushtoi 10 milionë dollarë kompanisë "Google". Ai ka shtypur një buton duke rritur shpërblimin për reklamimin e ofruar nga kompania prestigjioze. Ishte i bindur se po punonte në zonën e "testit" por, në fakt, ishte futur në modalitetin real dhe ka dër-



guar një njoftim të rremë publicitar në sajtet në inter-

net që përdorin "Google" për t'i shitur hapësirat e tyre.




DASHI

Nuk është se keni arritur të zgjidhni çështje që ju kanë shqetësuar këto kohë. Kjo gjë ju ka sjellë më shumë stres se zakonisht.



DEMI

Keni fituar pavarësi morale dhe financiare nga e shkuara juaj. Për këtë arsye jeni bërë më tolerant dhe më të hapur me të tjerët.



BINJAKËT

Një detaj po ju merr shumë kohë dhe po ju mundon sot më në fund do të gjejë zgjidhje. Ju doni të jeni i përkryer dhe do t'ia arrini qëllimit.



GAFORRJA

Keni filluar të keni më shumë besim te personat që ju rrethojnë dhe jo gjithmonë shtyheni nga instinkti për të zgjidhur një problem.



LUANI

Nuk keni shumë kohë për mëdyshje dhe dyshime sot. Njerëzit tuaj të dashur do t'ju kërkojnë ndihmë dhe duhet të jeni të gatshëm pa asnjë rezervë.



VIRGJËRËSHA

Keni zgjedhur mënyrën më të thjeshtë për të mos pranuar ndjenjat tuaja, duke shmangur një person të caktuar. Do të pendoheni më vonë.



PESHORJA

Komunikimi është shumë i rëndësishëm sot. Nëse nuk bisedoni si me kolegët ashtu edhe me partnerin, çështjet e mbartura nuk do të gjejnë zgjidhje.



AKREPI

Një person ka krijuar një ide të gabuar për ju që nuk i korrespondon realitetit. Nëse doni të sqaroheni, mund ta ftoni për një takim.



SHIGJETARI

Keni vënë baza të forta për të ardhmen tuaj profesionale dhe jeni mjaft të qetë ndaj çdo ndryshimi që mund të ndodhë.



BRICJAPI

Duhet t'i mirëkuptoni pjesëtarët e familjes sot që nuk do të aprovojnë një vendim tuajin që dashur padashur i kushtëzon edhe ata.



UJORI

Nuk keni zgjidhje tjetër sot përveçse të merrni në dorë situatën dhe të mundoheni t'i zgjidhni ngërçet e krijuara sepse mund t'ju prishin punë.



PESHQIT

Keni qenë shumë të ndjeshëm ndaj ngjarjeve dhe personave që keni pasur pranë, por tashmë keni ndryshuar qëndrimin nisur nga një situatë e caktuar.

BARSOLETA E DITËS



- Bir, a e kalove testin e vozitjes?
- Nuk e di, se po pres derisa të dalë instruktori prej spitalit.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

"ALPHA" 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson
Regjia: Albert Hughes

Vetem gjate vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

"JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN"

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennessy, Jake Lacy, etj.
Regjia: David Kerr



Në ora 18:00

"NIGHT SCHOOL"

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.
Regjia: Malcolm D. Lee



Në ora 20:00

"SIBERIA",

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.
Regjia: Matthew Ross



Në ora 22:00

"VENOM" 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.
Regjia: Ruben Fleischer
Based on the Marvel Comics



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).

Rita Ora bashkëpunon me David Guettan për projektin e radhës



Rita Ora ka pasur një vit të suksesshëm sa i përket karrierës muzikore jashtë vendlindjes. Këtë vit shqiptarja solli shumë projekte muzikore të cilat u renditën të parat në top listat botërore, si dhe mbajti shumë koncerte anembanë botës. Ritën

shumë shpejt do ta shohim edhe në një projekt muzikor bashkë me Dj David Guettan. Këtë gjë e bënë të ditur pasi ishin të pranishëm te "Capital FM Jingle Bell Ball". Kujtojmë se Rita kishte bashkëpunuar me Guetta në vitin 2015 në këngën "Poison".

Kaia Gerber shpallet modeluesja e vitit



Kaia Gerber, vajza e supermodelueses Cindy Crawford, është kurorëzuar me çmimin modeluesja e vitit në ngjarjen vjetore të Fashion Awards 2018. Kaia është bërë modeluesja më e re që nderohet me këtë çmim. Supermodeluesja u përball me

konkurren të forta si Adut Akech, Adwoa Aboah, Bella Hadid dhe Winnie Harlow për ta marrë në shtëpi çmimin prestigjioz. Kjo është një arritje e pabesueshme për adoleshentën që filloi modelimin shtatorin e kaluar, vetëm katër ditë pas ditëlindjes së saj të 16.



Britney shihet me një shirit me veshë kafshësh me të dashurin e saj

Imazhet shqetësuese të këngëtares kanë mbetur në të kaluarën. Dhe me jetën e saj të vendosur në rrugë të drejtë, Britney Spears do të ketë një vit të ri të zënë me projekte. Fillimisht ajo është duke shijuar disa ditë gjatë pushimeve në Los Angeles me të

dashurin e saj, Sam Asghari. Në një shëtitje të rastësishme, Britney u pa e veshur me një shirit me veshë të kafshëve dhe një bluzë të bardhë të tejdukshme. Çifti u fotografua derisa po ecnin krah për krah. Britney është 37-vjeçare, ndërsa i dashuri i saj 24-vjeçar.

Kendall Jenneri shfaqet elegante në Fashion Awards



Supermodeluesja e famshme Kendall Jenneri ka qenë një nga yjet që ka rënë më së shumti në sy gjatë mbrëmjes së Fashion Awards 2018. Jenneri u

shfaq në tapetin e kuq, e veshur me një fustan ngjyrë ari, transparent, që i ekspozonte format e saj. Kendall duket shumë seksi dhe tërheqëse.

Hotelet, më i madhi, më i vogli dhe më i çuditshmi në botë

Të flesh në një Beetle ose në një dhomë prej 83 mijë dollarësh në natë. Zgjedhja është e juaja

Ata që duan pushime origjinale dhe mbi të gjitha që i ndajnë ato në rrjetet sociale, janë të vetëdijshëm se origjinaliteti i vendit apo i hotelit është thelbësor për të tërhequr vëmendjen dhe për të fituar "like". Hotelscan.com ka zgjedhur disa vende unike në llojin e tyre, ku duke kaluar qoftë edhe një natë të vetme, do t'i lini ndjekësit tuaj me gojë hapur.

1. Hoteli më i lartë – Gevora në Dubai dominon klasifikimin e hoteleve më të larta në botë, me 75 kate dhe një lartësi prej 356 metra, vetëm një më shumë se JW Marriott Marquis Hotel, gjithashtu në Dubai. Pesë restorantet e tij ofrojnë një larmi të madhe atmosferësh dhe kuzhinash të ndryshme. Ky hotel mbresëlënës i artë ka një banjë ekskluzive, dy palestra, një për burrat dhe një për femrat dhe një pishinë të hapur. Superluksi fillon tashmë nga kati i parë kur hyni në një nga dyert e rrotullimit të hollë të arit

MGM Grand në Las Vegas, me 6,198 dhoma. Ndërtesa kryesore ka 5,044 (4,293 dhoma dhe 751 suita) në të cilën janë shtuar 576 suita të vendosura në tre kullat 'The Signature', 51 hyrjet e Skylofts dhe 29 vila të 'The Mansion at MGM Grand'. Por, MGM Grand do të duhet t'ia lëshojë vendin e parë në renditjen e hoteleve më të mëdha në botë hotelit Abraj Kudai, aktualisht në ndërtim në Mekë, me 10,000 dhoma të vendosura në dymbëdhjetë kulla, 70 restorante dhe katër heliports. Një kompleks maksi që do të mburret edhe me kupolën më të madhe në botë.

3. Më i vogli – Është e komplikuar të përcaktohet se cili është në fakt hoteli më i vogël në botë; në njërin anë mund të jetë Central Hotel & Café në Kopenhagë, i cili ka vetëm një dhomë prej 12 metrash katrorë, por me të gjitha llojet e rehatisë, që gjendet mbi kafeterinë



në holl. Pastaj, një nga tetë ashensorët që pret mysafirët në vetëm 38 sekonda në katin e 75-të, ku ka një pishinë spektakolare në çati me pamje mahnitëse të qytetit. Është e admirueshme të shijosh një koktej apo të bësh një dush.

2. Më i madhi – Hoteli më i madh në botë është aktualisht

Granola Cafe në lagjen Vesterbro. Rekordi i është dhënë Eh'haeusl of Ambreng në Gjermani, në rajonin e Bavarisë, me një dhomë të vetme prej 56 metra katrorë. Për Hotelscan.com, nga ana tjetër, hoteli më i vogël në botë është një beetle e bardhë Volkswagen që ndodhet në Jordani, pikërisht në Al Jaya, në jug të kryeqytetit



Amman. Një strehim unik i përshtatshëm për dy persona.

4. Më i vjetri – Hoteli më i vjetër në botë, ku mund të qëndroni ende, është Nishiyama Onsen Keiunkan, që ndodhet pranë malit Fuji, në Japoni, menaxhuar nga jo më pak se 52 breza të së njëjtës familje që e hapën atë në vitin 705. Në vitin 1997 u rinovua, duke ruajtur estetikën e tij tradicionale.

5. Më i shtrenjti – Suita Imperiale e Presidentit Wilson, hotel në Gjenevë, Zvicër. Qëndrimi brenda natës kushton 83.000 dollarë, rreth 71.670 euro. Mysafirët që mund ta përballojnë atë, ndihen në siklet nga zgjedhja: kjo megasuitë zë tërë katin e tetë të hotelit dhe përbëhet nga 12 dhoma, 12 banja prej mermeri me produktet Hermès, një tarracë me pamje nga liqeni i Gjenevës dhe Mont Blanc, një ashensor privat, një dhomë studimi, një

dhomë ngrënie për 26 veta, një dhomë gjumi prej 230 metrash me një tavolinë pishinash të Brunswickit të vitit 1930 dhe një piano të madhe të Steinway-it, një bibliotekë me një koleksion të librave antikë, dritare antiplumbash dhe mundësinë e një evakuimi të veçantë të helikopterëve. Përveç kësaj, paketa e qëndrimit përfshin një kuzhinier, një shërbëtor, një shofer dhe një asistent personal.

6. Më i ftohti – I famshmi 'Ice Hotel' në Jukkasjärvi, Suedi, i ndërtuar me blloqe akulli që shkrihen çdo pranverë dhe që rindërtohen çdo dimër, mund të konsiderohet hoteli më i ftohtë në botë, edhe pse ai ofron edhe dhoma të nxehta. Dhomat e ftohta kanë një temperaturë midis -5 dhe -8 gradë dhe secila prej tyre ka një temë të veçantë dhe mobilie prej druri të gdhendur me dorë nga artistë ndërkombëtarë.

7. Më "i thelli" – 'Desert Cave Hotel' është i vetmi hotel tërësisht nën tokë në botë. Nuk bëhet fjalë vetëm për hotelin, është një qytet i tërë kështu, i quajtur Coober Pedy, në mes të shkretëtirës australiane. Në 'Desert Cave Hotel', 19 dhomat janë të bollshme dhe kanë tavane të larta, por janë gdhendur në shkëmb.

8. Më i pjerrëti – Hotel Hyatt Capital Gate në Abu Dhabi është hoteli më i pjerrët në botë, i vendosur në mes të kateve të 18-të dhe 33-të të 'Capital Gate Tower', 165 metra e lartë dhe që ka një pjerrësi prej 18 gradësh, katër herë më i lartë se Kulla e Pizës. 165 metra i lartë, e cila ka një pjerrësi prej 18 gradë, katër herë më e lartë se Kulla e Pizës. Hoteli me 5 yje ka 189 dhoma dhe suita, një pishinë, një palestër, vaska hidromasazhi dhe spa e famshme e njohur si "Sky Spa" për pamjen e pabesueshme të qytetit.

9. Më nënujori – 'Conrad Maldives Rangali Island Hotel' në Maldive do të ofrojë një suitë që do t'i lejojë mysafirët të flenë nën ujë. Kjo është dhoma e parë e këtij lloji që do të ndërtohet në ujërat reale të oqeanit në vend të ujërave artificiale, siç kanë bërë tashmë hotelet e tjera. Emri i tij është Muraka (që do të thotë "koral" në dhivehi, gjuha lokale maldiviane) dhe ka dy kate: kati i sipërm lundron në ujë, ndërsa në katin përdhës është zhytur më shumë se pesë metra nën sipërfaqen e oqeanit.

10. Ai me pishinën më të thellë – Italia gjithashtu hyn në librin Guinness për hotelin me pishinën më të thellë në botë: është Hotel Millepini, i cili ndodhet në Montegrotto Terme, në Veneto dhe ka një pishinë të thellë 42 metra, ekuivalente me një ndërtesë 14-katëshe. Është quajtur Y-40 Deep Joy dhe përveç që përdoret nga mysafirët e hotelit është një atraksion që tërheq adhuruesit e zhytjes nga e gjithë bota.

(gazeta-Shqip.com)



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE	VALENCIA - MAN UTD	2	BENFICA - AEK ATHENS	1-1	PLZEN - ROMA	2
-------------------	--------------------	---	----------------------	-----	--------------	---

Eliminimi nga Kupa ua 'mbyll' gojën futbollistëve të Gjilanit

KF Gjilani është eliminuar nga Kupa e Kosovës në futboll, kurse sezonin vjeshtor e mbylli në pozitën e katërt. Futbollistët nuk kanë pranuar të flasin për gazetë, kurse trajneri Sadat Pajaziti e ka pranuar se Gjilani nuk e meritoi kualifikimin në çerekfinale të Kupës



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 11 DHJETOR - Skuadra e Gjilanit është eliminuar në 1/8 e finales së Digitalb Kupës së Kosovës në futboll, pasi ka pësuar humbje nga Ballkani i Suharekës (3-0). Këtë eliminim skuadra nga Anamorava e ka pranuar shumë rënd, çfarë dëshmon edhe heshtja e futbollistëve të kësaj skuadre. Gazeta ka kontaktuar dy nga futbollistët e kësaj skuadre të cilët nuk kanë qenë të gatshëm të japin deklarata lidhur me eliminimin dhe rezultatet e skuadrës në sezonin vjeshtor. Ata kanë thënë se situata në klub nuk është aspak e mirë dhe se tash për tash nuk duan të flasin për medie. Gazeta provoi të marrë një deklaratë edhe nga trajneri Sadat Pajaziti, por kjo ka qenë e pamundur, derisa vetë strategu nga Lugina e Preshevës, menjëherë pas eliminimit nga Kupa, e kishte pranuar se kjo skuadër nuk e ka merituar të kualifikohet

më lart në garën e Kupës. "Më vjen keq vetëm për këta tifozë që po na përkrahin gjatë gjithë kohës, por ky ekip nuk meriton të shkojë më larg", kishte deklaruar Pajaziti, i cili me këtë rast kishte bërë me dije se skuadrës së Gjilanit i duhet kohë për ta fituar titullin e kampiones apo Kupën. "Ne duhet të sjellim përforsime më cilësore dhe brenda 2-3 vjetëve të ndërtojmë filozofinë e lojës dhe t'ua sjellim tifozëve titullin kampion", kishte

thënë Pajaziti. Risi tjetër në skuadrën e Gjilanit ka qenë edhe largimi i dy futbollistëve të huaj, Mauricio Marinho dhe Trevin Ceasar. Skuadra e Gjilanit, edhe përkundër investimeve të shumta në afatin kalimtar të verës, u eliminua nga gara e Kupës, kurse sezonin vjeshtor e mbylli në pozitën e katërt me 27 pikë të grumbulluara, 13 pikë me pak se skuadra e Prishtinës që është lidere në Superligë.

Caktohen çiftet në çerekfinalen e Kupës

Në praninë e Komisionit të Garave dhe përfaqësuesve të klubeve është bërë tërheqja e shortit për çerekfinalen e Digitalb Kupës së Kosovës në futboll. Kampionia vjeshtore dhe fituesja e Kupës në vitin e kaluar, Prishtina, në çerekfinale do të përballet me Trepçën '89, kurse Feronikeli do të ketë punë me Ferizajn. Kampionia në fuqi e elitës, Drita e Gjilanit, luan ndaj Vëllanzimit,

kurse Kika do ta kërkojë kualifikimin në gjysmëfinale në përballje me Ballkanin. Ndashjet e këtij rrethi do të zhvillohen më 9 shkurt 2019.

Çerekfinalja e Kupës

Ferizaj - Feronikeli
Prishtina - Trepça '89
Kika - Ballkani
Vëllanzimi - Drita

SHKURT

Duka sërish kandidon për t'u bërë anëtar i Komitetit Ekzekutiv të UEFA-s

Presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit, Armand Duka, do të kandidojë sërish në zgjedhjet që do të mbahen në shkurt të 2019-s për t'u bërë anëtar i Komitetit Ekzekutiv të UEFA-s. "Miq të mi, do të jem një nga kandidatët për anëtar të Komitetit Ekzekutiv të UEFA-s. Shpresoj që në Kongresin e 43-të që do të mbahet në Romë, më 7 shkurt 2019, të ketë sa më shumë federata mbështetëse. Kandidoj me dëshirën për ta përfaqësuar futbollin shqiptar dhe interesat e federatave të vogla në organin më të lartë të futbollit evropian", ka shkruar Duka në "Facebook".

Llapi interesohet për Shillovën

